



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi Komunal



12 Nr. 060/03-3424 dt. 22-01 2021

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 29/01/2021 (e Premte) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.


THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 28.12. 2020.
2. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar – Dhjetor 2020.
3. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2020:
 - a. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.
 - b. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
 - c. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
 - d. Komiteti për Barazi Gjinore.
4. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu .
5. Të ndryshme.

Drenas, 22.01. 2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 22. 01.2021, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca se kemi dhe një pika shtesë për rendin e ditës,ku kryetari mori fjalën dhe propozoi : 1. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores se Heroit te Kombit Asllan Fazliu .

Pastaj mori fjalën Burim Bujupi i cili propozoi për kërkesën për shërim jashtë vendi për ushtarin Shpëtim Heta .

Ku kryetari i dha përgjigjeje se ka marrë një vendim për ndarjen e shumës prej 1500€.

Të gjithë anëtarët e K. P. F-ca u pajtuan me rendin e ditës me një pikë shtesë, dhe u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët:

- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 21.12.2020.

- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

2. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar – Dhjetor 2020

- **Rekomandohet për Kuvend**

3. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2020:

a. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.

b. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.

c. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

d. Komiteti për Barazi Gjinore.

- **Rekomandohet për Kuvend**

4. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores se Heroit të Kombit Asllan Fazliu .

- **Votuan 07,vota Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

5. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 10: 50.


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12.060-2281 dt. 15.01 2021

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
28.12.2020**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **28.12.2020**

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30, anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.11. 2020.
2. Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.
3. Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021.
4. Propozim Rregullorë për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
5. Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.
6. Diskutimi i Planit të Integritetit.
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit “Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.
8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja jo profitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021.
9. Propozim Vendim për këmbimin e njësive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Gllogoc.
10. Propozim Vendim për përmisimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.
11. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Gllogoc, për operim.
12. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
13. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 28/12/ 2020 ishin: Kryetari Kuvendit Komunal Ramiz Lladrovci, Nënkryetari Nazmi Hasi, Shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, këshilltarët e KK, zyra e informimit si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit pasi përshëndeti të pranishmit, i njoftoi me rendin e ditës anëtarët e kuvendit, dhe hedhi në votim rendin e ditës ,ky rend ditë kalojë ne mënyre unanime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e parë 1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.11. 2020

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj:** hedhi ne votim pikën e parë 1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.11. 2020, edhe kjo pikë u votua në mënyre unanime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën dytë 2.Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj** hedhi ne votim pikën dytë 2.Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.

Gjithwashtu edhe kjo pikë u votua në mënyre unanime.

Sabrije Kukaj –nuk kam vërejtje sa i përket planit ,po me qenë se dy anëtarët e KPF-së që kanë qenë në opozitë dhe janë pjesë e komitetit për politik e financa ndoshta kish qene e moralshme prej vet këtyre anëtareve me e lirua vendin ,dhe me ju kalua përsëri opozitës përsëri dy vende ne KPF-ca .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: është në vullnetin e tyre ,por me ia marr të drejtën askush nuk ka të drejt sepse të gjithë janë të regjistruar në KQZ, dhe ashtu si janë regjistrua vazhdojnë ,sepse ligjet kështu thonë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tret 3.Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: në këtë planë janë përcaktua prioritet në realizimin e projekteve ,në planin e ekzekutivit është përfshi zyra e kryetarit ,njësit tjera dhe të gjitha drejtorit ku sipas planifikimit janë përcaktua edhe objektivat dhe përgjesit e së cilit, si qeveri lokale jemi të obliguar të bëjmë planifikime për vitin e ardhshëm prandaj e kemi dërgua në mbledhje të kuvendit për tu diskutua ,dhe marrë sugjerime apo propozime nga na e juaj unë jam i gatshëm nëse ka dikush ndonjë sugjerime propozim që ne të ndryshojmë planin e punës që e kemi planifikua ne ju faleminderit .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj ju ftoj të votoni pikën :3.Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021. Gjithashtu edhe kjo pikë kalon në mënyrë unanime

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katër 4.Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Të gjitha Komunat janë duke e bërë një rregullore të tillë, është derivat i ligjit, nëse nuk ka diskutime atëherë ju ftoj të votoni . 4.Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës .**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj** : edhe kjo pikë kalon në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë 5.Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.

Sabrije Kukaj : unë e kam lexuar me vëmendje, Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.p.sh për fshatrat kanalizimi i ujërave të zeza Baice, Krajkov ,Damanek ,Shtrubullo

me sa e kam vërejt unë për ujësjellës për fshatrat që janë pa ujë ,nuk kam parë që ka mjete të ndara me sa e kam parë dhe lexuar unë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci -Plani preliminar i Prokurimit është i miratuar mbi bazën e ndarjeve buxhetore plani është se cilin projekt të cilin e qojmë në zyrë të prokurimit më herët ose me vonë nëse keni ndonjë kërkesë për ndonjë projekt me dërgua me herët në Mars jo në Shtator na thoni pra këto mund të diskutohen nuk, diskutohet a ka para për ujësjellës a për kanalizim a nuk ka ,a është bashkë Krajkova me Baicen a nuk është bashkë sepse tash me janë mbete shumë pak lagje ose shtëpi pa u lidhe në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza .

Sabrije Kukaj – e kam cekur disa herë që ndërtimi i rrugës po i dëmton gypat e ujësjellësit, që kanë qenë donacion zviceran ,dhe ata gypa ju shumë mirë e dini që janë në oborr të kompanisë të mirëmbajtjes qindra metra që është i këputur faktikisht rruga që i ka këput gypat e ujësjellësit, unë nuk e di si i kë njerëzit ti që punojnë në terën po në shumë fshatra nuk ekzistojnë edhe nëse janë ato gypat e ujësjellësit ,që janë bërë me herët i ka mbuluar asfalti e dikun nuk ka hiq d.m.th ujësjellësi nëpër fshatra duhet me u shikuar me rend gypat se nuk janë kërka, sepse gypin kryesor nuk e ke askund në disa vende e ke të këputur kur janë bërë këto rrugë dhe askush nuk ka dalë me shikuar edhe pse edhe ne kohën e Idriz Hysenit që ka qenë drejtor e kam ngrit këtë çështje ,por askush nuk u merr me këto punë ,gypat janë këtu në oborr të komunalis edhe ti e din .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci -unë ku jam bërë kryetar i kam shkruar imell drejtorëve te mi , në rast se kryetari ju kërkoi me shkel ligjin ,çfarëdo veprimi me ktheni me imell dhe me thoni zoti kryetar kjo që po kërkoni ju është shkelje ligjore dhe ne këtë nuk e bëjmë ,nëse ti po me kërkon me shkel ligjin unë ,me fillua investimet ne rrjetet sekondare me bërë rrjet të ri pa i parë procedurat pa i lidhe rrjetet me e i parë rrejtët a funksionojnë ajo dhe me e dërgua në prokurori ,unë nuk e bëjë sepse nuk jam i interesuar me bërë shkelje ligjore .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hedhi në votim pikën e pestë 5. Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.

Edhe kjo pikë e rëndit të ditës kalon në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën gjashtë 6.Diskutimi i Planit të Integritetit. Pasi diskutime kalojmë të pika e radhës sepse kjo pikë nuk votohet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën shtatë 7.Propozim Vendim për financimin e Projektit “Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.

Vehbi Berisha –faleminderit kryesues vetëm deshta me e shtuar këtë që e kemi ngrit këtë shqetësim edhe gjatë mbledhjeve të tjera , mua me erdhi mirë dhe natyrisht që e përkrahi këtë propozim vendim për shkak se është mjaft i qëlluar faleminderit .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hedhi në votim pikën e shtatë 7.Propozim Vendim për financimin e Projektit “Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.

Edhe kjo pikë e rëndit të ditës votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e tetë: 8.Propozim Vendim për lirimin nga qiraja jo profitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hedhi në votim pikën 8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja jo profitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021. Edhe kjo pikë e rëndit të ditës votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e nëntë 9. Propozim Vendim për këmbimin e njërive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Gllogoc. Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hedhi në votim 9. Propozim Vendim për këmbimin e njërive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Gllogoc. Edhe kjo pikë e rëndit të ditës votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e dhjetë 10. Propozim Vendim për përmisimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

Sabrije Kukaj – nëse ka mundësi një sqarim për atë parcelën në Polluzhë, se nuk e pata shumë të qartë, asgjë tjetër nuk jam kundër vetëm deshta me ditë me hollësisht.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani – përsëritje për të gjithë pacela 144/0 në Polluzhë është në brezin kufitar në rrugën regjionale Drenas Skenderaj më qenë së kjo parcelë kufizohet me rrugë gjatë azhurimit është bërë një gabim teknik është bërë 0 e ne realitet kjo është parcelë 144/0ky gabim është bere gjate përpilimit të listës ne Excel kur është punuar, është pronë komunale ka qenë e lëshuar në shfrytëzim të përkohshëm një personi me herët.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hedhi në votim pikën e dhjetë 10. Propozim Vendim për përmisimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021. Edhe kjo pikë e rëndit të ditës votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë 11. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Gllogoc, për operim.

Sabrije Kukaj – me vjen mirë për këtë propozim vendim dhe e përkrahi për arsye se kompanitë e transportit në këtë kohën e pandemisë kanë operua me vështirësi shumë të mëdha dhe është një hap jashtëzakonisht i mirë, dhe një ndihme për ata.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hedhi në votim pikën e 11. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Gllogoc, për operim.

Edhe kjo pikë e rëndit të ditës votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë 12. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: ky është raport vetëm diskutohet nuk votohet të pika 13. Të ndryshme: fjalën e merr Vehbi Berisha.

Vehbi Berisha: me qenë së jemi ne sezonën dimërorë dhe është i nevojshme pastrimi i rrugëve kisha një pyetje se a keni marr masa në këtë drejtim apo si është situata drejtoresh

nëse kishe mund me na njoftua se tash po janë te lidhura njëra me tjetrën ,kompania e pastrimit nuk po del me i mbledh mbeturinat nëpër kontejnerë nganjëherë edhe ka një muaj po ndodhë, thjeshte po i inkason të hyrat e nuk del me i mbledh mbeturinat pyetja ime e dytë është për çështjen e koordinatorëve ose administratoreve të fshatit ne, me rregullore e kemi paraparë një kompensimi që pritet me ju bërë ,kur pritet me u bërë ky kompensim dhe a është paraparë nëse ka mundësi me u përgjigj në këto pyetje ?

Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia Lumnije Krap –përshëndetje për të gjithësia i përket projekteve mirëmbajtja e rrugëve për sezonin dimëror ,e kemi lidhur kontratën me kompaninë Pastrimi ,ndërsa sa i përket çështjes së që ka ndodhë me u vonua largimi i mbeturinave nuk e di që ka ndonjë vonesë të natyrës së tillë ,për një ditë mundet me ndodhë edhe për atë ditë e bëjmë lajmërimin në web faqe të komunës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci -sa i përkëtë pagesës së administratoreve për derisa sa niveli qendror nuk na lejon vijë buxhetore ne nuk mund ti paguajmë dhe nuk ka pagesa ne jemi mundu në dy rastet kur kemi ndihmua qytetarët me pako ushqimore për të gjithë ata që kanë pas nevojë ,edhe atyre ju kemi shpërndare me aq sa kemi pas mundësi kemi bërë ,në rregullore nuk është pagesa e administratoreve ,ne i kemi kompenzu në ato mënyra si kemi mund me i kompenzu ,pasi është mbledhja e fundit për këtë vit ju urojë të gjithëve juve dhe familjeve të juaja vitin e ri dhe shpresoj që të kaloi pandemia sa me shpejt sepse ka qenë një vit i rëndë për të gjithë ju faleminderit .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj :urime festa edhe nga unë suksese për të gjithë edhe ne vitin e ardhshëm .

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 50 min.

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		22/01	2021
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400-	3325	

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT



RAPORTI FINANCIAR
I Zhvillimit Të Buxhetit Janar - Dhjetor 2020

JANAR 2021

Baza për Raportim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP-së) përkatësisht neni 45.4, kryetari i komunës duhet të përgatit dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të vitit i cili sa po ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo periode, dhe më pasë duhet të publikohen në faqen e internetit të komunës.

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftoi Bordin e Drejtorve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal, të gjitha mediet (elektronike dhe të shkruara) si dhe qytetarët për realizimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese janar-Dhjetor 2020. Buxheti komunal për periudhën janar-Dhjetor 2020 nënkupton Ligjin .06/L-133 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri sa buxheti paraqet qëllimet e performancës, raporti paraqet masën deri në të cilën qëllimet e performancës janë arritë, duke përfshi vlerësimin kuantitativ dhe kualitativ të rezultateve. Ky raport gjithashtu paraqet edhe krahasime me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Në këtë raport paraqitet mënyra e realizimit të buxhetit për nga karakteri ekonomik në pesë kategori kryesore ekonomike të shpënzimit; ndërsa për nga karakteri funksional në njëzetë (20) programe -nënprograme buxhetore.

Të dhënat e raportit për shpenzimet operative (Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime të Shërbimeve Komunale dhe Subvencio) dhe Shpenzime të Investimeve Kapitale, janë në harmoni me Departamentin e Thesarit pranë Ministrisë për Financa, ndërsa të dhënat për numrin e punëtorve dhe shumat për shpenzimet e Pagave dhe Mëditjeve me Shërbimin e përllogaritjes së pagave Ministrin e Administratës Publike.

Përgatitja e raportit është bërë në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit 03/L-048, të ndryshuar me Ligjin 04/L-221, dhe Standardet Ndërkombtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) bazuar në para të gatshme-raportimi financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Në raport vërehet se programet - nënprogramet rëndësi të veçantë i kanë dhënë shpenzimit të mjeteve të financuara nga Grantet Qeveritare si burim kryesor i të hyrave, pasi të hyrat nga burimet vetanake janë në disponim për shpenzim pa ndoni shkurtime eventuale nga Qeveria. Zyra e Kryetarit gjatë përgatitjes së këtij raporti s' bashku me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa është munduar me përkushtimin më të madh që me detaje dhe saktësi të paraqes realizimin-zhvillimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese, gjegjësisht janar-Dhjetor/020. Valuta raportuese është Euro (€).

Në mirëpresim çdo koment që do të kontribonte pozitivisht në përmirësimin e raporteve të ardhshme.

Tabela Nr.1 Buxheti Komunal të rishikuar sipas Ligjit Nr.07/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës /2020, shprehur në euro.

Tab.nr.1

Përshkrimi	Buxheti	Pagat	Mallra e shërb.	Shpenz.Kom.	Subv.e transf.	In.Kapitale	Rezerva	Nr.punt
Z.Kryetari	229,439.00	140,339.00	44,518.00	-	6,000.00	-	38,582.00	19
Adm.person	618,858.00	221,372.00	138,065.00	1,549.00	1,167.00	227,240.00	29,465.00	42
Inspektorati	108,264.00	67,478.00	37,515.00	-	-	-	3,271.00	11
Z.Kuvendit	149,557.00	108,920.00	24,140.00	-	-	-	16,497.00	-
Buxhet dhe finan.	120,906.00	97,032.00	18,340.00	-	-	-	5,534.00	16
Shërb Pub. Em.	694,357.00	182,357.00	274,365.00	55,495.00	10,000.00	172,140.00	-	25
Infrastruktur Publ	2,907,712.00	47,423.00	23,460.00	-	-	2,830,517.00	6,312.00	8
Z.K.Kthim	10,106.00	7,963.00	1,083.00	-	-	-	1,060.00	1
Bujqësia	143,788.00	70,530.00	11,181.00	-	58,355.00	-	3,722.00	13
anif.dhe Zhvill.Eko	80,268.00	42,906.00	24,348.00	-	-	-	13,014.00	8
Gjeodezi dhe Kad.	305,277.00	77,810.00	5,110.00	-	-	212,000.00	10,357.00	13
Urbanizmi	93,566.00	47,199.00	18,235.00	-	-	21,850.00	6,282.00	8
Administrata Sh.	360,824.00	35,778.00	60,338.00	-	259,200.00	-	5,508.00	5
Kujd.Prim.Shënd	2,057,015.00	1,336,255.00	325,360.00	45,288.00	-	345,344.00	4,768.00	181
Shërb Sociale	111,720.00	77,713.00	16,713.00	5,951.00	-	-	11,343.00	14
Kultura dhe sporti	411,720.00	66,081.00	49,449.00	-	77,393.00	210,045.00	8,752.00	13
Adm. Arsim	933,296.00	75,833.00	315,266.00	-	84,478.00	441,201.00	16,518.00	12
Ars.Parafillor	185,770.00	118,025.00	46,482.00	6,120.00	-	-	15,143.00	22
Ars. Fillor	5,501,307.00	4,468,470.00	299,835.00	61,312.00	-	24,069.00	647,621.00	739
Ars. I Mesem	1,506,709.00	1,259,517.00	75,507.00	19,625.00	-	-	152,060.00	175
	16,530,459.00	8,549,001.00	1,809,310.00	195,340.00	496,593.00	4,484,406.00	995,809.00	1325

Deri sa tabela e lartë shënuar paraqet buxhetin-planifikimin e të hyrave dhe të dalave-shpenzimeve, tabelat në vazhdim të raportit paraqes zhvillimin e buxhetit, po ashtu për të hyra dhe të dala për periudhën raportuese.

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar - Dhjetor 2019 dhe krahasimi i tyre me një vit më parë.

Tabela nr.2


Nr.renc	Muaji	Plani 2020	Realizimi 2020	Real.Vitit 2019	% me plan	Krahasimi me 2018%
1	Janar	115,899.17	98,915.00	63,385.74	85.35	156.05
2	Shkurt	115,899.17	102,622.35	62,163.01	88.54	165.09
3	Mars	115,899.17	48,700.69	68,044.30	42.02	71.57
4	Prill	115,899.17	15,706.41	326,539.03	13.55	4.81
5	Maj	115,899.17	30,286.37	99,535.75	26.13	30.43
6	Qershor	115,899.17	104,193.43	120,062.87	89.90	86.78
7	Korrik	115,899.17	63,223.38	108,191.70	54.55	58.44
8	Gusht	115,899.17	81,502.90	114,872.24	70.32	70.95
9	Shtator	115,899.17	65,817.61	85,552.07	56.79	76.93
10	Tetor	115,899.17	102,546.81	151,681.97	88.48	67.61
11	Nëntor	115,899.17	64,037.47	75,750.37	55.25	84.54
12	Dhjetor	115,899.17	107,432.35	102,306.47	92.69	105.01
	Totali	1,390,790.00	884,984.77	1,378,085.52	63.63	64.22

Vërejtje :Shenime nga raporti i free balance të datës 13.01.2021 pa gjoha trafiku dhe gjykatav.

Ndërsa nese ja shtojmë dhe gjobat e gjykatav dhe trafikut dhe grantet e performances shuma arrin në: 1,480,372.40 €

Tabela Nr.2, paraqet të dhënat lidhur me arkëtimin e të hyrave nga burimet vetanake për periudhën janar- Dhjetor të vitit fiskal 2020, të krahasuara me periudhën e njejt të vitit paraprak. Krahasuar me planifikimin (1,390,790.00 €) të hyrat nga burimet vetanake janë realizuar 63.63 % , ndërsa në raport me periudhën e njejt të një vitit më parë kemi renje të performancës për 36.37%, ne këtë raport nuk janë paraqitur të hyrat indirekte nga gjykatat dhe gjobat e komunikacionit dhe grantet e performancës (595,387.63).

Paraqitja grafike e planifikimit të të hyrave dhe realizimit për periudhën Janar - Shtator të vitit 2020.



Pasi që më lart është bërë shpallja e të hyrave vetanake të planifikuara e të realizuara, duke u krahasuar me vitin paraprak, kurë është fjala të Grantet Qeveritare planifikimi vjetor është i paraparë të jetë në shumë prej: 15,099,553.00€, nga kjo del periudha raportuese do të jetë në shumë prej:15,099,553.00 €, ndërsa me buxhet paraqitet shuma prej:15,125,742.03 €,

Të dhënat e raportit të Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar tregojnë se ndarjet nga Grantet janar-Dhjetor paraqesin shumën prej: 15,125,742.03€, krahasuar me planifikimin kemi ndarje sipas planifikimit, apo (26,189.03) por shumë që nuk e kemi pas ne dispozicion për shpenzim

Shikuar ndarjet Alokimet) e Granteve (15,090,741.90 €) për nga karakteri i shpenzimeve, shpenzimet operative (P&M, M&Sh,Sh.Sh.K) marrin pjesë në shumë prej :10,517,068.90 €, apo 69.969 %; kurse Sh.Kapitale me shumën prej:4,397,518.00€, apo 29.14 %,Subvencionet me 1.16% Në periudhën janar-Dhjetor/019, (Alokimi) pranimet-të hyrat për nga burimet e financimit janë realizuar si vijon:

* Grantet Qeveritare (Burimi i financimit 10) = 15,090,741.90 €,

*Të Hyrat nga Burimet Vetanake 2019 (Burimi i financimit 21) = 1,075,214.96 €, të alokuara

*Të Hyrat nga Burimet Vetanake 2018 (Burimi i financimit 22) = 1,125,676.61 €, dhe

*Donacionet (Burimi i financimit 31) =22,563.87 €.

* Grande për performanc (59-61) =328,500.00 €

* Të hyrat nga Huaja (04) = 132,725.00 €

Gjithsejt pranime 17,775,422.37

Zhvillimi i buxhetit komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2020 lidhur me të dalat-shpenzimet

Dihet se komuna shpenzimet i menaxhon përmes llogarisë së vetme të Thesarit (LVTH) e cila mbulohet nga Autoriteti Bankar i Kosovës (AQBK) më këtë Nr.1000650070000022.

Procesi i shpenzimeve është i përfshirë në disa koncepte kryesore (Ndarje teknike) lidhur me shpenzimin e parave publike, së pari kemi të bëjmë me delegimin e përgjegjësisë nga Zyrtari Kryesor Administrativ të menaxherët e programev-nënprogrameve, njëherit mbajtës të buxheteve, procesë ky si çdo vit edhe në këtë, është bërë në janar/020 nga ana e Kryetarit të Komunës, proces i cili ngrit transparencën dhe performancën, krahas përgjegjësisë. Në vijim kemi edhe këto ndarje teknike - koncepte kryesore:

- * Ndarja buxhetore ,
- * Akordimi I fondeve ,
- * Zotimi I fondeve ,
- * Inicimi I shpenzimeve ,
- * Prokurimi,
- * Pranimi I mallerave - shërbimeve ,
- * Pagesa e faturave dhe
- * Lëshimi I fondeve nga llogariza bankare.

Per të arritur qëllimet e një performance sa më të mirë në drejtim të shfrytëzimit të parase publike (Vlera për paranë) me kohë në janar të këtij viti është përgatitur Plani I zotimit dhe shpenzimit të parase së gatshme sipas periodave të vitit 2020 dhe është dorëzuar në Departamentin e Thesarit-M.F si para kushtë të ndarjes së mjeteve. Për këtë periode mjetet financiare janë akorduar sipas planit , Pagat dhe Mëditjet një e dymbdhjeta e buxhetit për muaj; ndërsa për kategorit tjera ekonomike të shpenzimeve sipas planit.

Në tabelat vijuese është bërë paraqitja e zhvillimit të buxhetit si për nga karakteri ekonomik, e poashtu edhe funksional I planifikimit dhe shpenzimit.

Realizimi - shpenzimi I buxhetit komunal sipas Programëve-nënprogrameve për periudhën Janar -Dhjetor 2020

Zyra e Kryetarit

Tab.3

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Mëditjet	112,761.68	112,761.68	114,876.84	100.00	100.00	112,761.68
2	Mallrat dhe Sherbimet	40,548.32	36,802.85	39,399.09	90.76	90.76	40,548.32
3	Subvencione dhe transf.	1,903.50	1,500.00	8,000.00	78.80	27.26	5,503.50
4	Investime Kapitale	-	-	-	-	-	-
Totali		155,213.50	151,064.53	162,275.93	97.33	95.12	158,813.50

Administrata dhe Personeli

Tab.4

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Mëditjet	205,908.58	205,908.58	201,743.84	100.00	100.00	205,908.58
2	Mallrat dhe Sherbimet	138,064.99	126,412.12	133,854.07	91.56	91.56	138,065.00
3	Shpezimet Komunale	1,549.00	1,396.18	128.22	90.13	90.13	1,549.00
4	Subvencione dhe transf.	250.00	-	1,580.00	-	-	1,242.00
5	Investime Kapitale	227,240.00	220,837.00	53,571.42	97.18	97.18	227,240.00
Totali		573,012.57	554,553.88	390,877.55	96.78	89.61	574,004.58

Drjtorati I Inspektionit

Tab.5

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Mëditjet	71,133.11	71,133.11	58,154.06	100.00	100.00	71,133.11
2	Mallrat dhe Sherbimet	31,490.90	23,641.24	27,524.99	75.07	75.07	31,490.90
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	-	-	-	-	-	-
Totali		102,624.01	94,774.35	85,679.05	92.35	92.35	102,624.01

Zyra e Kuvendit Komunal

Tab.6

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Mëditjet	110,557.30	110,557.30	99,391.15	100.00	100.00	110,557.30
2	Mallrat dhe Sherbimet	19,473.93	17,919.92	15,087.93	92.02	92.02	19,473.94
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		130,031.23	128,477.22	114,479.08	98.80	98.80	130,031.24

D.për Buxhet dhe Financa

Tab.7

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me Alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Mëditjet	86,942.82	86,942.82	89,486.26	100.00	100.00	86,942.82
2	Mallrat dhe Sherbimet	18,340.00	16,760.89	15,950.82	91.39	91.39	18,340.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		105,282.82	103,703.71	105,437.08	98.50	98.50	105,282.82

Sherbimet Publike Emergjente

Tab.8

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me Alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Mëditjet	202,936.60	202,936.60	152,360.04	100.00	100.00	202,936.60
2	Mallrat dhe Sherbimet	251,364.84	222,479.49	252,530.44	88.51	88.51	251,364.84
3	Shpezimet Komunale	85,495.00	85,491.79	51,859.56	100.00	100.00	85,495.00
4	Subvencione dhe transf.	6,366.63	6,273.69	11,637.37	98.54	98.54	8,657.63
5	Investime Kapitale	149,782.71	115,644.26	266,355.59	77.21	77.21	177,332.71
Totali		695,945.78	632,825.83	734,743.00	90.93	90.93	725,786.78

D. Infrastruktura Publike

Tab.9

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me Alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	40,406.39	40,406.39	31,709.21	100.00	100.00	40,406.39
2	Mallrat dhe Sherbimet	13,403.94	7,784.33	20,257.42	58.07	58.07	13,403.94
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	4,739,030.12	3,568,726.43	2,946,297.15	75.30	75.30	4,822,154.66
Totali		4,792,840.45	3,616,917.15	2,998,263.78	75.47	75.47	4,875,964.99

Zyra për Komunitete dhe Kthim

Tab.10

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me Alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	3,300.20	3,300.20	4,166.82	100.00	100.00	3,300.20
2	Mallrat dhe Sherbimet	1,083.09	618.20	355.11	57.08	57.08	1,083.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		4,383.29	3,918.40	4,521.93	89.39	89.40	4,383.20

D.e Bujqësisë

Tab.11

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	66,874.48	66,874.48	69,792.75	100.00	100.00	66,874.48
2	Mallrat dhe Sherbimet	11,181.00	10,405.44	10,586.54	93.06	93.06	11,181.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	48,729.25	48,283.78	56,446.15	99.09	93.91	51,416.25
5	Investime Kapitale	22,563.87	20,350.62	22,690.85	90.19	-	22,563.87
Totali		149,348.60	145,914.32	159,516.29	97.70	95.97	152,035.60

D.për Planifikim dhe zhvillim Ekonomik

Tab.12

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me Alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	39,055.23	39,055.23	27,853.08	100.00	100.00	39,055.23
2	Mallrat dhe Sherbimet	20,185.50	18,465.88	31,880.56	91.48	91.48	20,185.50
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		59,240.73	57,521.11	59,733.64	97.10	97.10	59,240.73

D.Sherbimeve Kadastrale

Tab.13

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	64,179.32	64,179.32	73,043.12	-	100.00	64,179.32
2	Mallrat dhe Sherbimet	5,110.00	4,836.39	4,349.49	-	94.65	5,110.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	212,000.00	191,904.10	56,879.95	-	90.52	212,000.00
Totali		281,289.32	260,919.81	134,272.56		92.76	281,289.32

D.për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit

Tab.14

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	30,755.18	30,755.18	36,702.43	100.00	100.00	30,755.18
2	Mallrat dhe Sherbimet	15,950.34	14,253.68	16,597.69	89.36	89.36	15,950.34
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	4,750.00	4,288.17	80,894.96	90.28	19.63	21,850.00
Totali		51,455.52	49,297.03	134,195.08	95.81	71.91	68,555.52

D.Administratës Shëndetësi

Tab.15

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	35,756.73	35,756.73	33,812.25	100.00	100.00	35,756.73
2	Mallrat dhe Sherbimet	53,801.89	51,947.88	57,470.21	96.55	96.55	53,801.90
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	231,343.01	204,040.00	27,915.75	88.20	76.86	265,453.01
Totali		320,901.63	291,744.61	119,198.21	90.91	82.18	355,011.64

Sherbimet Primare Shëndetësore

Tab.16

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	1,526,891.75	1,526,891.75	1,243,350.61	100.00	100.00	1,526,891.75
2	Mallrat dhe Sherbimet	387,836.78	237,927.42	193,605.70	61.35	60.15	395,524.82
3	Shpezimet Komunale	42,985.00	42,184.38	44,170.03	98.14	98.14	42,985.00
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	353,987.28	229,467.12	357,052.25	64.82	64.82	353,987.28
Totali		2,311,700.81	2,036,470.67	1,838,178.59	88.09	87.80	2,319,388.85

Sherbimet Sociale

Tab.17

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	77,235.57	77,235.57	69,714.16	100.00	100.00	77,235.57
2	Mallrat dhe Sherbimet	10,304.39	8,618.25	15,310.74	83.64	83.64	10,304.40
3	Shpezimet Komunale	3,786.15	3,057.45	5,600.96	80.75	80.75	3,786.16
4	Subvencione dhe transf.		-		-	-	
Totali		91,326.11	88,911.27	90,625.86	97.36	97.36	91,326.13

D.për Kultur Rini dhe Sport

Tab.18

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	61,076.05	61,076.05	65,741.47	100.00	100.00	61,076.05
2	Mallrat dhe Sherbimet	41,033.27	34,271.41	40,065.81	83.52	83.52	41,033.28
3	Shpezimet Komunale		-		-	-	
4	Subvencione dhe transf.	80,300.39	79,700.00	60,199.61	99.25	99.25	80,300.39
5	Investime Kapitale	226,545.00	170,585.15	260,748.04	75.30	75.13	227,045.00
Totali		408,954.71	345,632.61	426,754.93	84.52	84.41	409,454.72

D. Administratës Arsim

Tab.19

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	67,839.91	67,839.91	62,925.63	100.00	100.00	67,839.91
2	Mallrat dhe Sherbimet	510,285.46	361,766.76	247,436.26	70.89	70.89	510,285.46
3	Shpezimet Komunale		-		-	-	
4	Subvencione dhe transf.	96,349.90	92,000.00	79,700.00	95.49	95.49	96,349.90
5	Investime Kapitale	609,594.16	528,623.69	486,901.05	86.72	71.97	734,533.16
Totali		1,284,069.43	1,050,230.36	876,962.94	81.79	74.54	1,409,008.43

Arsimi Parafillor

Tab.20

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	121,099.10	121,099.10	118,022.00	100.00	100.00	121,099.10
2	Mallrat dhe Sherbimet	50,075.14	19,285.16	34,690.55	38.51	31.58	61,068.65
3	Shpezimet Komunale	6,120.00	3,134.70	6,000.00	51.22	51.22	6,120.00
4	Subvencione dhe transf.		-		-	-	
Totali		177,294.24	143,518.96	158,712.55	80.95	76.22	188,287.75

Arsimi Fillor

Tab.21

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	4,352,003.64	4,352,003.64	4,355,840.55	100.00	100.00	4,352,003.64
2	Mallrat dhe Sherbimet	299,834.56	109,316.15	280,266.63	36.46	36.46	299,834.56
3	Shpezimet Komunale	61,312.00	42,410.03	60,493.00	69.17	69.17	61,312.00
4	Subvencione dhe transf.		-		-	-	
5	Investime Kapitale	24,069.00	20,951.50	12,572.20	87.05	87.05	24,069.00
6	Rezerva						35,000.00
Totali		4,737,219.20	4,524,681.32	4,709,172.38	95.51	94.81	4,772,219.20

Arsimi I Mesem


Tab.22

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet	Shpenzimi19	% me alokim	% buxh planifikuar	Buxh.planif
1	Pagat dhe Meditjet	1,248,156.40	1,248,156.40	1,242,692.94	100.00	100.00	1,248,156.40
2	Mallrat dhe Sherbimet	75,507.03	38,379.80	69,695.12	50.83	50.83	75,507.03
3	Shpezimet Komunale	19,624.99	17,091.25	19,000.00	87.09	87.09	19,625.00
4	Subvencione dhe transf.		-		-	-	
Totali		1,343,288.42	1,303,627.45	1,331,388.06	97.05	97.05	1,343,288.43

KOMUNA

Tab.23

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet SIMFK-së	shpenzimet 2020	Shpenzimi 2019	Shpenzimi18	% me alokim	Buxh.planif	Buxheti Final
1	Pagat dhe Meditjet	8,524,870.04	8,524,870.04	8,150,885.21	8,088,930.96	100.00	8,524,870.04	8,524,870.04
2	Mallrat dhe Sherbimet	1,994,875.37	1,363,444.26	1,506,915.17	1,269,356.61	68.35	2,013,556.98	1,994,875.37
3	Shpezimet Komunale	220,872.14	194,765.78	187,251.77	150,368.47	88.18	220,872.16	220,872.14
4	Subvencione dhe transf.	465,242.68	431,797.47	245,478.88	232,616.27	92.81	508,922.68	465,242.68
5	Investime Kapitale	6,569,562.14	5,071,378.04	4,543,963.46	4,133,704.84	77.20	6,822,775.68	6,569,562.14
6	Rezerva						35,000.00	
Totali		17,775,422.37	15,586,255.59	14,634,494.49	13,874,977.15	87.68	18,125,997.54	17,775,422.37



Nese e shiqojm shumën e paraqitur në kolonen e buxhetit planifikuar shofim se shuma arrin në 18,125,997.54 euro, por ne si Komun kemi pasur të disponueshem vetem buxhetin në shumën prej: 17,775,422.37 euro qe dmth se kemi pasur ma pakë mjete ne disponim në shumë prej: 350,575.17 eurove.

Në tabelen e lartë shenuar është paraqitur gjendja e mjeteve të alokuara janar - Dhjetor/20 sipas karakterit ekonomik të shpenzimit, planifikimi i shpenzimit dhe shpenzimi. Ndarja e mjeteve nënkupton kërkesa e komunës për t'i pasur mjetet në disponim që t'i zotojë për të krijuar mundësi të porosisë së shërbimit-mallit; ndërsa me planifikim është menduar masa e shpenzimit të mjeteve, pasi të jenë përmbushur kërkesat ligjore të pagesës. Në ndarjen e përgjithshme (17,775,422.37€) Kategorija Ekonomike e Shpenzimeve Kapitale merr pjesë 36.96%, mjete këto të alokuara në disponim për t'i kryer zotimet, para se të lidhen kontratat.

Shfrytëzimi i mjeteve të ndara (17,775,422.37) në këtë vit është realizuar (15,586,255.59) 87.68 %, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (14,634,494.49) kemi rritje të performancës për+ 6.50 %.

Në kategorin mallra dhe shërbime kemi të alokuar më shumë shumën prej :18,681.61 €.

Në kategorin e Subvencioneve dhe Transfereve kemi alokim më pakë për :43,680.00€

Në kategorin e Investimeve kapitale kemi të alokuar më shumë shumën prej: 2,085,156.14 € dhe atë si rezultat i bartjeve dhe Grantëve të donatorëve të brendshëm dhe performancës të fituara nga Komuna.

Ndërsa sa i përket dy kontratave kolektive si Sektori i Arsimit dhe ai i Shëndetësisë i kan kushtuar buxhetit të komunës në vlerë prej : 157,863.77 €, dhe atë nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve janë marr mjete në shumë prej:157,863.77 €.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Prantë:	12-01	20-21	
Org.	Numër	Shtojca	Vlera
12-052	1468		



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Glogocit (Drenasit)
Kuvendi Komunal



RAPORT VJETOR

MBI PUNËN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA NË KOMUNËN E DRENASIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR
2020

Anëtarët:

Ariana Isufi
Arlindë Krasniqi
Burim Fazliu
Jehona Abdylit
Shemsi Bërbatovci

PËRMBAJTJA

I PJESA HYRËSE	4
Prioritetet përgjatë vitit 2020.....	5
II PJESA TEMATIKE	6
Mbledhjet e Realizuara & Aktivitete të rëndësishme.....	6
Mbledhja e parë.....	6
Mbledhja e dytë.....	7
Mbledhja e tretë.....	9
Mbledhja e katërt.....	10
Mbledhja e pestë.....	11
Mbledhja e gjashtë.....	13
III PJESA PËRMBYLLËSE	16
Konkluzione & Rekomandime.....	16
Objektivat e arritura & Rezultatet.....	16
Kufizime.....	17
Propozime për ndryshim & Rekomandimet për vitin 2021.....	18
Planet prioritare të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2021.....	18
Foto nga aktivitetet e Realizuara.....	20

SHKURTESAT

KKPAK - Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PAK - Persona me Aftësi të Kufizuara

AK – Aftësi e Kufizuar

QPS – Qendra për Punë Sociale

OJQ - Organizata Jo Qeveritare

ZP - Zyra e Punësimit

QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit

DKRS - Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

DSHMS – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

(I)**PJESA HYRËSE****PARATHËNIE**

Komuna e Drenasit, me vet aktin e themelimit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka vënë në prioritetet e veta edhe këtë kategori të qytetarëve të saj, kurse në anëtarët e përzgjedhur në realizimin e mandatit tonë, vazhdojmë t'i kryejmë përgjegjësitë tona duke bashkëpunuar me legjislativin dhe ekzekutivin komunal, si dhe akterë të tjerë.

Me qëllim të transparencës dhe me qëllim të informimit të komunitetit të personave me nevoja të veçanta, si dhe të institucioneve komunale për punën dhe aktivitetet tona, duke iu përmbajtur kontinuitetit në raportim, Komiteti Konsultativ për PAK i Komunës së Drenasit, publikon këtë raport për të përmbledhur punën, aktivitetet dhe mbledhjet e realizuara, gjatë vitit 2020.

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), si organ drejtues i ri institucional, është formuar për herë të parë në komunën e Drenasit në vitin 2019, dhe si i tillë, vepron në harmoni me “Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komitetitve Konsultative në Komuna”. Përmes mbledhjeve të realizuara, anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK kanë shqyrtuar dhe diskutuar në hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e veta, dhe kanë vënë disa prioritete. Specifikisht, si qëllim prioritar i këtij komiteti është të sigurojë përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me nevoja të veçanta, duke nxitur dhe siguruar mundësinë që të gjithë personat me nevoja të veçanta në territorin e Komunës së Drenasit t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kjo gjithnjë në bashkëpunim të përhershëm me vet këta persona, me institucionet komunale, me OJQ-të që ofrojnë shërbime psiko-sociale, e veçmas me ato OJQ që ofrojnë shërbime me përfshirje të PAK.

Për t'i arritur objektivat e synuara, Komiteti Konsultativ për PAK me fillim vit, ka hartuar planin e punës dhe kalendarin për takime për vitin 2020, në bazë të të cilit dhe ka realizuar aktivitetet. Megjithatë, meqenëse, aktivitetet e pothuajse të gjithë sektorëve në këtë vit janë ndikuar nga pandemia Covid-19, kjo situatë ka ndikuar edhe tek ne që të bëjmë një ridizajnim të planit të punës, por maksimalisht jemi munduar që të mos lejojmë të na pengoj në realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Drenasit, Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje të rregullta, por jo vetëm. Përveq mbledhjeve të rregullta, ky komitet ka mbajtur më shumë se tetë (8) takime të tjera konsultative, përmes të cilave janë konkretizuar ide dhe specifika në aspektin e përmirësimit të jetës së personave me nevoja të veçanta - në komunën e Drenasit. Mbledhjet formale, zakonisht ky komitet i ka mbajtur në zyrën

pranë byfese në Komunën e Drenasit, në fund të muajit, kurse takimet tjera konsultative i ka zhvilluar në terren dhe sipas rastit.

Në vazhden e aktiviteteve tona, krahas planit të punës, ky komitet ka identifikuar një sërë nevojash për ndryshim në të mirën e PAK, andaj, përmes punës në terren, takimeve me personat kompetent, përfshirë zyrtarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të OJQ-ve, familjar të PAK dhe me vet PAK, kemi arritur të nxjerrim disa rezultate të cilat më pas janë ngritur në formën e rekomandimeve (propozimeve për ndryshim) dhe janë diskutuar me digaster të ndryshëm. Pas diskutimit, bashkërisht jemi dakorduar që këto rekomandime të shërbejnë për përpjekjet e duhura për ndryshim në vitin 2021.

Prioritetet përgjatë vitit 2020

- ◆ Bashkëpunime të ndërsjellta me Institucionet Komunale të Drenasit, me qëllim të rritjes së involvimit të personave me nevoja të veçanta në procesin e vendimarrjes. Kjo përmes takimeve konsultative, në afatet kohore të harmonizuara me axhendat e institucioneve përkatëse.
- ◆ Angazhim për bashkëpunime të ndërsjellta me OJQ-të që përfaqësojnë persona me nevoja të veçanta, për t'i dëgjuar kërkesat dhe propozimet e tyre për Komunën e Drenasit, në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të caktuara të nivelit komunal të qeverisjes.
- ◆ Shkëmbimi i përvojave me homologë/ anëtarë të këtij komiteti nga komunat e tjera, me qëllim të informimit për përvojat pozitive në kuadrin ligjor, në zbatueshmërinë e tij, në organizimin dhe rolin e entiteteve të aftësisë së kufizuar në këto komuna, si dhe me pjesëmarrjen aktive të këtij komuniteti në rrjedhat shoqërore dhe jetën publike.
- ◆ Marrja e pikëpamjeve, kërkesave, propozimeve dhe kritikave të qytetarëve, që kryesisht kanë të bëjnë me investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore, rrugëve, trotuarëve; ofrimin e shërbimeve shëndetësore për PAK, gjithpërfshirja e nxënësve, dhe përcjellja e prioriteteve të tilla tek akterët relevant.
- ◆ Realizimi i hulumtimeve në terren, mbi bazën e identifikimit të aspekteve prioritare që kanë të bëjnë me personat me nevoja të veçanta.
- ◆ Hartimi i udhëzuesve si dhe dhënja e propozimeve për rregulloret e hartuara nga institucionet komunale, që ndërliken me personat me aftësi të kufizuara dhe problematikat e shfaqura.
- ◆ Identifikimi i numrit të personave me nevoja të veçanta të regjistruar në zyrën e punësimit në Drenas, si të papunë, punëkërkuar dhe të punësuarit, shifra për vitet e fundit.
- ◆ Identifikimi i numrit të fëmijëve nën moshën 18 vjeç, dhe personave mbi moshën 18 vjeç, të cilët janë aktiv në marrjen e pensioneve si persona me nevoja të veçanta. Të bëhen analiza mbi numrin e përgjithshëm të banorëve në Drenas, dhe përqindjes së personave me nevoja të veçanta.

(II)

PJESA TEMATIKE

MBLEDHJET E REALIZUARA & AKTIVITETE TË RËNDËSISHME

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta, në periudhën Janar - Dhjetor 2020. Për shkak të Pandemisë Covid 19, mbledhjet nuk janë realizuar në kohën e paraparë me Planin e Punës, por e rëndësishme është që ato janë mbajtur të gjitha si dhe aktivitetet e planifikuara janë realizuar, madje janë arritur më shumë rezultate nga sa që kishim planifikuar për këtë vit.

Burimet e raportit përmbledhës të aktiviteve të realizuara për vitin 2020 janë ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve/takimeve të komitetit. Raporti, pas miratimit nga anëtarët e komitetit, do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Drenasit.

Procesverbali i Mbledhjes së parë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (24.01.2020)

Me datën 24.01.2020 Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Drenas, ka mbajtur mbledhjen e parë për të reflektuar mbi punën e vitit të kaluar, si dhe për të ideuar apo vënë në pah idetë mbi hartimin e Planit të Punës për vitin 2020. Të pranishëm në këtë takim ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti, përkatësisht: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli si dhe Shemsi Bërbatovci.

Mbledhja ka filluar në orën 14:00, në zyrën pranë byfesë në Komunën e Drenasit.

Hapjen e mbledhjes e ka bërë zv. kryesuesi i këtij komiteti, Ariana Isufi, e cila njëherish ishte procesmbajtës.

Zv. kryesuesi ka rekomanduar që të bëhet një përmbledhje e aktiviteve të vitit të kaluar, gjegjësisht e mbledhjes së fundit dhe pikave të rendit të ditës, nga ku kemi ardhur në konkluzione se aktivitetet janë realizuar me sukses, si dhe dy pikat e rendit të ditës së mbledhjes së fundit të vitit 2019 janë arritur, kjo ngase kemi identifikuar synime të përbashkëta me QPS si dhe me DKA, për të kontribuar për PAK.

Anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK, njëzëri kanë propozuar dy pika të rendit të ditës, dhe rëndësinë mbi realizimin e këtyre pikave.

Pikat e rendit të ditës:

1. Diskutim mbi rëndësinë e bashkëpunimit me psikologun komunal
2. Diskutim mbi rëndësinë e bashkëpunimit & takimeve konsultative me Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport (DKRS)
3. Të ndryshme
 - Lidhur me pikën e parë për rend dite, një nga anëtarët e këtij komiteti - Arlindë Krasniqi, ka propozuar takim dhe bashkëpunim me psikologun komunal, në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës në përgjithësi, dhe në veçanti lidhur me vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, kjo pasi që vitin e kaluar kemi pasur kërkesa nga mësimmhënësit e shkollave dhe drejtorët se identifikimi me kohë i vështirësive dhe problemeve të natyrave të ndryshme nga nxënësit me nevoja të veçanta, lehtëson mësimmnxënien për këta nxënës, por edhe mësimmhënien.
 - Lidhur me pikën e dytë, gjegjësisht propozimi i dhënë nga kryesuesi Shemsi Bërbatovci, për takim me përfaqësues të DKRS-së, është parë si i rëndësishëm në aspektin e marrjes së informatave nga kjo drejtori në lidhje me dhënjen e subvencioneve për OJQ-të që ofrojnë shërbime për PAK, dhe identifikimin e numrit të aplikimeve nga OJQ-të e tilla. Në debat, lidhur me pikat e rendit, janë involvuar edhe anëtarët tjerë me diskutim mbi rëndësinë e realizimit të këtyre aktiviteteve.
 - Tek të ndryshme, kemi planifikuar të bëjmë vizita në shkollat ku ka nxënës me nevoja të veçanta, dhe për të vëzhguar nga afër punën dhe barrierat me këta nxënës në klasa të rregullta.

Meqenëse, nuk kishte ndonjë pikë tjetër për diskutim, mbledhja u mbyll nga procesmbajtësi Ariana Isufi, në orën 15:10.

Procesverbali i Mbledhjes së dytë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (12.05.2020)

Me datën 12.05.2020 (e martë), Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e dytë me radhë për vitin 2020, në zyrën në xhama në Komunën e Drenasit.

Në këtë mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci.

Mbledhja filloi në orën 10:00 dhe procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi- zëvendës kryesuese e Komitetit Konsultativ për PAK.

Fjalën hyrëse në këtë mbledhje e bëri kryesuesi i këtij komiteti, z. Shemsi Bërbatovci.

Në pjesën e parë të takimit tonë, kryesuesi i KKPAAK ka kërkuar të reflektojmë në pikat e rendit të ditës së mbledhjes së fundit, dhe në mundësitë për realizimin e tyre, sfidat dhe rezultatet e arritura. Megjithatë, nga diskutimi i përbashkët kemi parë se pikat e rendit të ditës së mbledhjes së fundit në lidhje me bashkëpunimin me psikologun komunal dhe vizitat në shkollat ku ka fëmijë nevoja të veçanta kanë ngelur pa u realizuar për shkak të pandemisë Covid-19, dhe për shkak të refuzimit të psikologut komunal për të bashkëpunuar me këtë komitet.

Kurse sa i përket takimeve konsultative me përfaqësues të DKRS-së, e kemi shtyer për një muaj tjetër, për shkak se pandemia ka ndikuar të vëmë në prioritet aktivitete të tjera më të rëndësishme.

Pas këtij diskutimi, pjesa e dytë e takimit ju është përmbajtur pikave të rendit të ditës, të cilat ishin:

1. Planifikimi dhe shqyrtimi i mundësisë për të vizituar Dhomën Burimore (me nxënës me nevoja të veçanta) në Komoran, për të diskutuar në lidhje me realizimin e mësimit online në këtë kohë pandemie, sfidat, vështirësitë etj.
2. Riaktivizimi i ekipës vlerësuese komunale për nxënësit me nevoja të veçanta – rekomandim për drejtorinë përkatëse.
3. Diskutim rreth ndonjë hulumtimi të mundshëm apo punës në terren për raste të caktuara, që Komiteti e vlerëson të dobishme.
4. Të ndryshme
 - Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, kemi diskutuar mbi sfidat me të cilat mund ballafaqohet Dhoma Burimore në Komoran, lidhur me mësimin online për nxënësit e kësaj klase, si dhe kemi diskutuar mbi mundësinë e KKPAAK se çfarë mund të kontribuoj në këtë drejtim, dhe adresimi i nevojave për ndryshim tek DKA në Drenas.
 - Lidhur me pikën e dytë, kemi parë të rëndësishme të riaktivizohet ekipa vlerësuese komunale për nxënësit me AK, pasi që në shumë shkolla shihet se nxënësit duken të kenë vështirësi të ndryshme por vazhdojnë shkollën krahas aty vështirësive, pa ndonjë vlerësim të domosdoshëm. Pas involvimit në debat, anëtarje e këtij komiteti Jehona Abdyli, ka ndarë përvoja personale që ka kaluar me vajzën e saj, lidhur me mos vlerësimin me kohë dhe nga profesionistë të duhur.
 - Siç dihet, PAAK janë pjesa e shoqërisë e cila kërkon vëmendjen e duhur, andaj e kemi parë të rëndësishme që të realizojmë hulumtime të ndryshme në këtë fushë, që do t'i kontribuojnë nevojave të kësaj kategorie e që lidhet me ndikimin e pandemisë Covid-19. Bazuar në këtë fakt, kemi ideuar mbi një projektpropozim të mundshëm, për t'a finalizuar muajin e ardhshëm.

Meqenëse nuk kishte ndonjë pikë tjetër për diskutim, me kaq mbledhja e gjashtë e KKPAAK përfundoi, duke shpresuar në realizimin e aktiviteteve për mbledhjet e ardhshme. Mbledhja u mbyll nga procesmbajtësi - Ariana Isufi, në orën 11:30.

Procesverbali i Mbledhjes së tretë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (24.06.2020)

Mbledhja e tretë me radhë, në kuadër të Komitetit Konsultativ për PAK, është mbajtur me datë 24.06.2020, në një ndër zyret e Komunës së Drenasit.

Mbledhja filloi në orën 10:00 dhe procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi- zëvendës kryesuese në KKPAK.

Në këtë mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti, përkatësisht: Shemi Bërbatovci, Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Jehona Abdyli dhe Burim Fazliu. Përveq anëtarëve të këtij Komiteti, të ftuar për të diskutuar bashkë kishim edhe drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit, z. Muhamet Gjoka, i cili vazhdimisht ka treguar gatishmëri për të bashkëpunuar.

Fjalën hyrëse në këtë mbledhje e bëri kryesuesi i këtij komiteti, Shemi Bërbatovci.

Në pjesën e parë të takimit tonë, kemi diskutuar për pikat e rendit të ditës së mbledhjes së fundit, dhe për mundësitë rreth realizimit të tyre, sfidat dhe rezultatet e arritura, nga ku kemi parë se këto pika janë realizuar të gjitha me sukses, madje kemi arritur më shumë rezultate nga sa kemi planifikuar.

- Jemi takuar dhe kemi diskutuar me koordinatorin e Dhomës Burimore (me nxënës me nevoja të veçanta) në Komoran, në lidhje me realizimin e mësimin online në këtë kohë pandemie, ku kemi identifikuar sfidat dhe vështirësitë, të cilat në mbledhjet e ardhshme konsultative kemi vënë në prioritet t'i përcjellim tek drejtori i DKA-së, siç janë: mungesa e pajisjeve për mësim online nga nxënësit, dhe mungesa e strategjive të duhura nga mësimdhënësit, për t'i angazhuar këta nxënës në mësim në kohë pandemie. Këtij problemi i jemi përgjigjur me rezultatet e hulumtimit të realizuar, dhe me planin për hartimin e udhëzuesit.
- Në rrjedhën e aktiviteteve tona, kemi prioritetuar finalizimin e hulumtimit, i cili po ashtu konsiston si pikë e realizuar, kjo ngase kemi arritur të realizojmë hulumtimin online mbi "Sfidat e mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e komunës së Drenasit, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19", me mësimdhënësit në formën online. Bashkërisht kemi diskutuar rezultatet e hulumtimit, dhe rekomandimet që mund t'i ngrisim të cilat mund të sjellin benefite për grupin target. Drejtori i DKA-së z. Muhamet Gjoka, ka përgëzuar për angazhimin dhe ka inkurajuar për aktivitete të tilla.
- Kurse lidhur me pikën tjetër, për riaktivizimin e ekipës vlerësuese komunale për nxënësit me nevoja të veçanta, e kemi ngritur si shqetësim, përderisa sipas drejtorit të DKA-së është një aktivitet i vazhdueshëm që po punohet dhe duhet punuar personat kompetent.
- Lidhur me diskutimin për këto pika, edhe drejtori i DKA-së z. Gjoka, vazhdimisht ka dhënë përkrahje dhe ide për realizimin e aktiviteteve që lidhen me arsimin në përgjithësi.

Pas këtij diskutimi, pjesa e dytë e takimit ju është përmbajtur pikave të rendit të ditës, të cilat ishin:

1. Hartimi i një udhëzuesi i cili do të shërbej si një burim për mësimdhënësit në mësimdhënien me nxënësit me nevoja të veçanta, për aq kohë sa do të vazhdoj mësimi në distancë.

Në këtë pikë, kemi diskutuar lidhur me gjetjen e akterëve relevant për bashkëpunim, qoftë drejtor përkatës, zyrtarë, OJQ etj., për të bashkëdyzuar idetë në lidhje me hartimin e këtij udhëzuesi për mësimdhënës.

Meqenëse nuk kishte ndonjë pikë tjetër për diskutim, me kaq mbledhja e tretë përfundoi. Mbyllja u bë nga procesmbajtësi - Ariana Isufi, në orën 11:30.

Procesverbali i Mbledhjes së katërt të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (28.07.2020)

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e radhës, gjegjësisht mbledhjen e katërt me radhë për vitin 2020.

Takimin e kemi filluar në orën 13:20, në një ndër zyrët e komunës së Drenasit, përkatësisht në zyrën me xhama në katin e dytë.

Procesverbali është mbajtur nga zëvendës kryesuesi i Komitetit Konsultativ për PAK- Ariana Isufi.

Në mbledhje morën pjesë të gjithë anëtarët e komitetit, përveq kryesuesit- Shemsi Bërbatovci - për shkaqe shëndetësore. Respektivisht, anëtarët që ishin pjesë e kësaj mbledhje ishin: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu dhe Jehona Abdyli.

Të ftuar në pjesën e parë të takimit kishim, kryesuesin e kuvendit komunal të Drenasit, z. Labinot Halilaj.

Fjalën hyrëse në këtë mbledhje e bëri zëvendës kryesuesja e këtij komiteti, Ariana Isufi.

Pikat e rendit të ditës që kemi diskutuar në këtë mbledhje janë:

1. Diskutim i pikave të mbledhjeve të kaluara për vitin 2020, mbi realizimin apo mosrealizimin e aktiviteteve, bashkëpunimet, barrierat etj.

2. Diskutim mbi Udhëzuesin e hartuar (finalizuar) nga KKPAK, për mësimdhënësit në lidhje me mësimin në distancë/ online, për nxënësit me nevoja të veçanta.

3. Diskutim me DKA-në lidhur me mundësinë e ndarjes së pajisjeve të nevojshme (laptop etj), për ndonjë nxënës me nevoja të veçanta (në nevojë për këto pajisje), për të u mundësuar ndjekjen e mësimin online.

- Fillimisht, kemi bashkëbiseduar mbi aktivitetet e realizuara me sukses për vitin 2020, gjithmonë duke u bazuar në Planin e Punës me aktivitetet e planifikuara, të hartuar në fillim të vitit. Gjithashtu, bashkërisht me kryesuesin kemi diskutuar mbi realizimin e Hulumtimit dhe Udhëzuesit për mësimdhënës, në lidhje me mësimin online apo në distancë për nxënësit me nevoja të veçanta. Kryesuesi, ka përgëzuar Komitetin Konsultativ për PAK në lidhje me aktivitetet që vazhdon të jetë aktive në realizimin e tyre me sukses, si dhe ka rekomanduar zgjerimin e aktiviteteve në aspektin infrastrukturor, në aspektin e punësimit për PAK, ofrimin e shërbimeve shëndetësore, etj. Gjithashtu, kryesuesi ka shprehur gatishmëri që të jetë prezent në secilën mbledhje apo takim të planifikuar nga anëtarët e këtij komiteti që konsiderojmë të nevojshme praninë e tij.
- Pikat tjera të rendit të ditës, i diskutuam bashkërisht vetëm me anëtarët e KKPAK, sepse nga ora 14:00, ku kishim të ftuar drejtorin e DKA-së, z. Muhamet Gjoka, për shkak të angazhimeve të tij në punë, e kishte të pamundur pjesëmarrjen me kohë në takim.
- Si rezultat, pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës, kanë mbetur të diskutohen bashkërisht me drejtorin e DKA-së, në një mbledhje konsultative.

Pasi që nuk kishim ndonjë pikë tjetër për diskutim, mbyllja u bë nga procesmbajtësi: Ariana Isufi në orën 14:45.

Procesverbali i Mbledhjes së pestë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (18.09.2020)

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK) - Drenas, ka realizuar mbledhjen e pestë të rregulltë me radhë, me datë: 18.09.2020. Takimi është mbajtur në një nga zyret e komunës së Drenasit, përkatësisht në zyrën me xhama në katin e dytë.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin katër nga pesë anëtarët e KKPAK, përkatësisht morën pjesë: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci, përderisa, Burim Fazliu ka munguar, duke na lajmëruar paraprakisht për arsyet e mospjesëmarrjes.

Procesverbali është mbajtur nga zëvendës kryesuesja e KKPAK- Ariana Isufi, si dhe takimin me fjalën hyrëse e ka hapur Ariana Isufi, në orën 09:30.

Të ftuar në këtë takim kishim, dy akterë të institucioneve të ndryshme të komunës sonë:

- Drejtorin e OJQ-së HANDIKOS në Drenas, z. Behxhet Binaku, i cili na është përgjigjur pozitivisht ftesës sonë, duke na nderuar me pjesëmarrjen e tij, dhe involvimin në temat e rëndësishme që kishim për diskutim.

- Drejtorin për Infrastrukturë, z. Endrit Gllareva, i cili në pamundësi për të qenë personalisht në takim, ka dërguar një nga zyrtaret e drejtorisë së tij, përkatësisht znj. Liridona Durmishi Mulaku, pjesëmarrja e të cilës sigurisht ishte e rëndësishme, duke u involvuar poashtu në debat lidhur me infrastrukturën e PAK në komunën e Drenasit, si dhe duke diskutuar bashkërisht lidhur me adresimin e rekomandimeve të nevojshme tek kjo Drejtori.

Pikat e rendit të ditës ishin:

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar të Komitetit Konsultativ për PAK, të datës 27.08.2020
2. Diskutim lidhur me qasshmërinë në Infrastruktura për PAK në Drenas
3. Diskutim rreth Implementimit të legjislacionit për punësimin e PAK në Drenas, nevoja dhe mundësia për monitorim dhe rekomandimet për punësim.
4. Të ndryshme
 - Lidhur me pikën e parë, kemi konstatuar se përpjekjet tona lidhur me identifikimin e sfidave të mësimin online për nxënësit me nevoja të vecanta, si dhe hartimi i udhëzuesit për tejkalimin e këtyre sfidave, vetëm se konsistojnë të përfunduara suksesshëm nga KKPAAK, dhe pritet të publikohen përmes faqes së komunës dhe ndahen me mësimdhënësit e komunës së Drenasit.
 - Lidhur me pikën e dytë, fillimisht zëvendës kryesuesi i KKPAAK, ka hapur për diskutim disa nga sfidat që kemi identifikuar me të cilat ballafaqohen PAK në komunën tonë, në aspektin e infrastrukturës, si dhe kemi shfaqur interesim nëse drejtoria përkatëse, ka bërë ndonjë plan për lehtësimin e qasshmërisë së PAK. Fjala i kalohet zyrtares së drejtorisë së Infrastrukturës, znj. Liridona Durmishi Mulaku, për tu informuar më shumë lidhur me planet e drejtorisë së tyre, lidhur me qasshmërinë më të lehtë për PAK. Me ç'rast, zyrtarja në fjalë ka pohuar se drejtoria ku ajo punon ka planifikuar të ndajë një shumë parashë për lehtësimin e qasjes në rrugë dhe trotuare për PAK për vitin 2021, dhe ka kërkuar të jemi të hapur me ide dhe rekomandime në drejtorinë e tyre.
 - Sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, fjala i kalohet z. Behxhet Binaku, i cili na ka siguruar disa të dhëna apo statistika për numrin e PAK të punësuar në sektore të ndryshme në Drenas. Nga këto statistika, ne kemi parë që numri i të punësuarve i PAK në sektore të ndryshme, që Handikos ka identifikuar është vetëm 17, dhe si rezultat kemi zgjedhur që përmes zyrës së Entit për Punësim, të arrijmë të marrim numrin e saktë të atyre që kanë aplikuar dhe që janë punësuar. Gjithashtu, kemi planifikuar të japim rekomandime për punësimin e këtyre personave, bazuar në legjislacion si dhe të monitorojmë zbatimin e

legjislacionit, jo vetëm a kanë arritur të punësojnë PAK, por edhe lidhur me krijimin e kushteve fizike dhe të tjera, për të arritur që PAK të kryejnë shërbimet e duhura, pa u penguar nga aftësia e tyre e kufizuar.

Tek të ndryshme - Kemi diskutuar mbi nevojën e bashkëpunimit të drejtorisë së Shëndetësisë me OJQ-të, përkatësisht me HANDIKOS. Takimi përfundoi në ora: 11:20 dhe mbyllja u bë nga procesmbajtësi: Ariana Isufi.

Procesverbali i Mbledhjes së gjashtë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (25.11.2020)

Kjo mbledhje ishte e fundit për vitin 2020, ku të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti me përjashtim Shemi Bërbatovci, përkatësisht të pranishëm ishin: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Jehona Abdylit dhe Burim Fazliu.

Mbledhja filloi në orën 09:00 dhe procesverbali është mbajtur nga znjsh. Ariana Isufi- zëvendës kryesues i Komitetit Konsultativ për PAK.

Fjalën hyrëse në këtë mbledhje e bëri zv. kryesuesi i këtij komiteti, Ariana Isufi.

Në pjesën e parë të takimit tonë, zv. kryesuesi i KKPAK ka kërkuar të reflektojmë në pikat e rendit të ditës së mbledhjes së fundit, dhe në mundësitë për realizimin e tyre. Tek kjo pikë, përkatësisht tek diskutimi i pikës së parë për rend dite kemi mbetur që në fund të vitit të ngrisim disa rekomandime për Drejtorinë e Infrastrukturës lidhur me rregullimin e trotuareve dhe pjerrinave për qasje më të lehtë të PAK, si dhe ka mbetur të sigurojmë të dhëna aktuale të sakta nga zyra e entit për punësim në Drenas lidhur me numrin e punëkërkuësve dhe të punësuarve me nevoja të veçanta, në institucionet e komunës së Drenasit.

Pas këtij diskutimi, pjesa e dytë e takimit ju është përmbajtur pikave të tjera të rendit të ditës, të cilat ishin:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së fundit të rregullt, të dt: 18.09.2020 si dhe të mbledhjes konsultative të dt: 07.10.2020
2. Iniciativat e deritashme të Komitetit Konsultativ për PAK, sfidat dhe rezultatet e arritura
3. Përfshirja e PAK në aktivitetet e OJQ-ve aplikuese në shpalljet publike për grante dhe subvencione në kuadër të DKRS-së
4. Shërbimet shëndetësore në shtëpi për PAK, gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19
5. Diskutim mbi nevojën dhe mundësinë e monitorimit të zbatueshmërisë së legjislacionit për punësimin e PAK dhe dhënja e rekomandimeve
6. Diskutim mbi mundësinë e sigurimit të transportit shtëpi-shkollë, për nxënësit me nevoja të veçanta në komunën e Drenasit.

7. Të ndryshme

Për të diskutuar bashkë gjatë këtij takimi kishim disa të ftuar, ndër të cilët morën pjesë: Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, znj. Shqipe Zogu, si dhe të ftuar tjetër me kërkesën e saj, kishim U. Z., familjare e një vajze 16 vjeç me nevoja të veçanta nga Komuna e Drenasit.

- Sa i përket procesverbalit të mbledhjeve (takimeve) të fundit në kuadër të Komitetit Konsultativ për PAK, kemi arritur që të sigurojmë disa të dhëna të rëndësishme, megjithatë puna rreth këtyre aktiviteteve është një proces i vazhdueshëm.
- Lidhur me pikën e dytë, kemi bërë një reflektim në lidhje me çfarë kemi bërë përpjekje të realizojmë gjatë këtij viti, cilat kanë qenë sfidat në realizimin e aktiviteteve tona si dhe cilat janë rezultatet e arritshme. Megjithatë, këtë përmbledhje të aktiviteteve, kemi planifikuar t'a bëjmë në një takim të veçantë me Kryetarin e Komunës apo Nënkrjetarin, ashtu siç e parasheh edhe Udhezuesi në kuadër të të cilit veprojmë, por në pamundësi për t'u takuar për shkak të kohës së kufizuar në periudhën e ftesës për takim edhe ngazhimeve të këtyre të fundit, kemi vlerësuar të mjaftueshme raportimin përmes raportit vjetor.
- Lidhur me pikën e tretë, në diskutim me Drejtoreshën e DKRS-së, kemi shfaqur interesim në marrjen e informatave lidhur me numrin e OJQ-ve aplikuese në shpalljet publike për grante dhe subvencione në kuadër të DKRS-së që në aktivitetet e tyre i kanë të përfshirë PAK. Lidhur me këtë aspekt, drejtoresha në fjalë, ka pohuar se kjo përfshirje është në nivel të ulët për shkak të mos aplikimit të tyre, dhe jemi pajtuar bashkarisht që ne si komitet me rol ndërmjetësues mes OJQ-ve dhe Drejtorive përkatëse, t'i inkurajojmë OJQ-të të aplikojnë në thirrje të tilla. Megjithatë, Drejtoresha Zogu, ka pohuar se disa nga OJQ-të siç janë "Shqipet e Drenicës", "Organizata e të Shurdhërve", dhe të tjera kanë përfituar subvencione në kuadër të DKRS-së vazhdimisht.
- Lidhur me pikën e katërt, përkatësisht shërbimet shëndetësore në shtëpi për PAK, në kohë pandemie, ne si komitet kemi pranuar kërkesë verbale nga një qytetare, përkatësisht motra e një vajze me nevoja të veçanta që këto shërbime të ofrohen në kohën e duhur tek rastet më me urgjencë, ose të paktën kërkesën e saj ne si Komitet Konsultativ për PAK, t'a adresojmë tek drejtoritë përkatëse. Megjithatë, informatat që na janë dhënë nga doktori Burim Fazliu, njëherish anëtar i këtij Komiteti, kanë qenë se pacientët për të marrur shërbimet e nevojshme shëndetësore në shtëpitë e tyre, duhet të bëjnë kërkesë më herët, dhe të gjitha shërbimet kryhen me kohë dhe sipas planifikimit. Por, për të mos e neglizhuar si kërkesë, ne si komitet kemi vendosur që përmes emailit ta përcjellim tek drejtori i QKMF- për shërbimet shëndetësore me kohë nga stafi në Komoran.
- Lidhur me pikën e pestë dhe të gjashtë, gjatë diskutimit me anëtarët e komitetit kemi planifikuar që në një të ardhme të afërt t'i ftojme drejtorët e Drejtorive si për Shërbime Publike si dhe Drejtorin e Arsimit, në mënyrë që të diskutojmë bashkarisht në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit për punësimin e PAK si dhe sigurimin e transportit shtëpi-shkollë, për nxënësit me nevoja të veçanta në komunën e Drenasit.

Meqenëse nuk kishte ndonjë pikë tjetër për diskutim, me kaq mbledhja e gjashtë e Komitetit Konsultativ për PAK përfundoi, duke shpresuar në realizimin e aktiviteteve për mbledhjet e ardhshme. Takimi u mbyll nga procesmbajtësi - Ariana Isufi, në orën 11:40.

(III)

PJESA PËRMBYLLËSE**KONKLUZIONE & REKOMANDIME**

Komiteti duke parë rëndësinë e bashkëpunimit dhe nxitjen e tij në realizimin e objektivave të veta, ka siguruar bashkëpunim institucional për PAK, nëpërmjet shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit dhe praktikës më të mirë. Ky raport është një sinjal i qartë se mbi bazën e aktiviteteve tona, kemi hipotetizuar e ngritur objektiva konkrete, kemi aranzhuar takime e vizita në terren me akter të ndryshëm, kemi identifikuar problematika, kemi parë nevojën për ndryshim dhe arritur rezultate konkrete. Andaj, sipas kësaj logjike, kemi ardhur në përfundim mbi nevojën e ngritjes së disa rekomandimeve praktike, të cilat i kontribuojnë nevojës për ndryshime.

Objektivat e Arritura & Rezultatet

- ◆ Vitin e kaluar, kemi rekomanduar rritjen e numrit të mësuesve mbështetës në shkolla, dhe nga bashkëpunimi me DKA-në, kemi konstatuar që kjo drejtori ka reflektuar në aspektin pozitiv për vitin 2020, ka vazhduar me angazhimin e mësuesve mbështetës në shkolla.
- ◆ Në vazhden e aktiviteteve, komiteti ynë në kuadër të DKA-së ka propozuar identifikimin dhe rregullimin e pjerrinave në shkollat ku kanë nevojë për ndërhyrje dhe qasje më të lehtë për PAK, dhe nga takimet konsultative kemi parë se DKA përmes projekteve që synon t'i realizoj në vitin 2021 ka marrur në prioritet rregullimin e pjerrinave dhe Ashensorit, në shkollën e Gjimnazit.
- ◆ Një e arritur tjetër që Komiteti Konsultativ për PAK ka koontribuar në fushën e Arsimit është “Identifikimi i Sfidave e mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e komunës së Drenasit, gjatë periudhës së pandemisë Covic-19”, me anë të realizimit të një hulumtimi në formën online me mësimdhënësit e komunës së Drenasit.
- ◆ Pas identifikimit të këtyre sfidave, Komiteti ynë ka parë nevojën ofrimin e burimeve të reja për realizimin e mësimit online me nxënësit me nevoja te veçanta, dhe me profesionalizëm ka hartuar një udhësues si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, në ndihmë të mësimdhënësve, por edhe nxënësve dhe prindërve, si palë të involvuara në institucionet edukativo-arsimore, i cili është shpërndarë pastaj me mësimdhënësit e shkollave të komunës së Drenasit.
- ◆ Nga bashkëpunimi me Zyrën e Pensioneve në Drenas, kemi identifikuar numrin e aplikuesve për pensione të kategorive të ndryshme me nevoja të veçanta, nga ku kemi gjetur se vitin e fundit, pra në vitin 2020 kjo zyre ka pranuar mbi 60 aplikues mbi moshën 18 vjeç, kurse QPS ka pranuar 82 aplikues me AK nën moshën 18 vjeç, që gjithsej konsistojnë në mbi 140 aplikues për një vit. Sipas databazës së zyrës së pensioneve, nga viti 2004, në Komunën e Drenasit janë aktiv në marrjen e

pensioneve rreth 1000 PAK të kategorive të ndryshme, përfshirë (persona të verbër, paraplegjik, tetraplegjik, me nevoja të veçanta mendore etj).

◆ Nga zyra e Punësimit në Drenas dhe OJQ Handikos, në lidhje me identifikimin e PAK si punëkërkues, jemi informuar se nuk mund të vijm në përfundim me shifra të sakta se sa është numri i tyre, për shkak se shumë prej tyre gjatë regjistrimit nuk janë deklaruar si PAK, por janë regjistruar si të rregullt. Megjithëse, kur bëhet fjalë për punësimin e tyre, kemi gjetur se aktualisht rezultojnë të punësuar në institucionet e Komunës së Drenasit rreth 17 prej tyre, përkatësisht të angazhuarit më punë përfshijnë këto institucione: Shtëpi e Shëndetit, Komunë, Feronikel, Shkolla, KEK, Polici, Postë, Bankë dhe Kompani e Pastrimit.

◆ Gjithashtu, në aspektin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, kemi arritur që të identifikojmë dhe paraqesim pikëpamjet, kërkesat dhe nevojat e PAK tek personat kompetent, përkatësisht tek drejtori i QKMF-së në lidhje me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në shtëpi dhe me kohë, për PAK të palëvizshëm, në ato raste kur familja e ka të pamundur bartjen deri në QKMF.

◆ Në aspektin e përgjithshëm kemi arritur që në përpikmëri t'i përmbahemi Udhëzimit Administrativ, në harmoni me të cilin veprojme lidhur me realizmin e punës dhe aktiviteteve tona. Kjo gjithmonë duke e mbajtur të informuar zyrën e Kuvendit Komunal me procesverbalet e mbledhjeve, raportet tre mujore si dhe në takimet e realizuara me kryesuesin e Kuvendit Komunal.

Kufizimet

◆ Një nga kufizimet e aktiviteteve tona gjatë këtij viti, konsiderojmë mos identifikimin e më shumë OJQ-ve të reja nga ato ekzistuese të viteve të kaluara, të cilat përfaqësojnë persona me nevoja të veçanta në nivel lokal. Gjithashtu, janë aranzhuar më pak takime me OJQ-të aktive në Drenas, me përjashtim HANDIKOS, kurse disa shoqata të tjera sikurse ajo e të Shurdhërve, nuk i janë përgjigjur ftesave për takime konsultative.

◆ Si kufizim tjetër në aspektin e përgjithshëm të aktiviteteve tona ka qenë se disa prej sektorëve siç janë: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe të tjera janë shqyrtuar shumë më pak, kurse kontributin dhe angazhimin më të madh gjatë këtij viti e kemi orientuar në sektorin e arsimit, ndoshta pse e kemi parë nevojën më të madhe, ose sepse profesionet e shumicës nga anëtarët e këtij komiteti i përkasin fushës së Arsimit.

Propozime për ndryshim & Rekomandimet për vitin 2021

- ◆ Inkurajojmë Institucionet Komunale që ta njohin dhe zbatojnë të drejtën e personave me nevoja të veçanta për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë duke marrë hapat e duhur, përfshirë masat ligjore.
- ◆ Inkurajojmë OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale, të aplikojnë me projekte në Drejtoritë Komunale, që në thirrjet e tyre ofrojnë mundësi për ndarjen e granteve dhe subvencioneve përfshirë edhe fushën e PAK, ngase sipas të dhënave që posedojmë nga këto drejtori aplikimet e tilla janë të vogla në numër.
- ◆ Në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit, inkurajojmë ekipën vlerësuese, që të angazhohet në identifikimin e nxënësve me nevoja të veçanta, në shkolla. Kjo pasi që ne si komitet, kemi pranuar kërkesa nga disa drejtorë shkollash, se mësimdhënësve ju vështirësohet puna me këta nxënës ngase u mungon një vlerësim nga profesionistët për tu ofruar mësimin perkritazi me aftësinë e kufizuar të nxënësit.
- ◆ Rekomandojmë DKA –në për gjetjen e alternativave të mundshme për angazhmin e psikologëve në shkolla, kjo ngase siç e dijm roli i tyre është i domosdoshëm dhe nuk zëvendësohet as me pedagog dhe as me profesionistë të tjerë të fushave të ngjashme.
- ◆ Inkurajojmë Drejtorinë e Infrastrukturës në identifikimin e gjitha pikave në trotuare ku nuk ka mundësi për lëvizje të lirë, dhe rekomandojmë rregullimin e trotuareve, pjerrinave në rrugë (qytet), për qasje më të lehtë të PAK.
- ◆ Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përkatësisht në kuadër të QKMF-ve, rekomandojmë ofrimin e shërbimeve shëndetësore më kohë në zonat rurale për PAK, familjarët e të cilëve parashtrajnë kërkesë paraprakisht me arsyetimin se nuk kanë mundësi t'i bartin ata deri tek institucionet ku ofrohen këto shërbime. Këto shërbime, veçmas janë kërkuar me një kujdes të shtuar në kohën e Pandemisë Covid-19.

Planet Prioritare të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2021

- ◆ Realizimi i hulumtimeve me përfshirje kompanive private dhe bizneseve private, për të nxjerrur statistika të sakta nëse kanë të punësuar me AK.
- ◆ T'i inkurajojmë personat me nevoja të veçanta, gjithmonë duke shqyrtuar mundësitë për një ambient të përshtatshëm që të zhvillojnë dhe përdorin potencialin e tyre krijues, artistik, dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por gjithashtu për pasurimin kulturor të shoqërisë.
- ◆ Komiteti do të angazhohet në monitorimin aktiv të implementimit të legjislacionit për PAK, përmes takimeve mujore me institucionet, si dhe përmes bisedave joformale me zyrtarët e tyre.

Pjesë e këtij monitorimi do të jetë edhe zbatimi në praktikë i konkluzioneve dhe rekomandimeve të mbledhjeve të Komitetit.

♦ Shkëmbimi i përvojave me komitetet e komunave të tjera për PAK, për të dhënë ide, për të trajtuar problematikat dhe për të diskutuar për një orientim kundrejt mënyrave me efektive të përmirësimit dhe zgjidhjes sa më të mirë për PAK, si grup target në kuadër të aktiviteteve të Komitetit Konsultativ për PAK.

♦ Hartimi i Materialeve/ Broshurave vetëdijësuese, dhe publikimi i tyre, përveç fushatave ekzistuese, të cilat kanë impakt të zvogëlojnë mundësinë për të diskriminuar qytetarët në bazë të aftësisë së kufizuar.

♦ Komiteti Konsultativ për PAK do të angazhohet që institucionet e arsimit në nivel komunal, të garantojnë një sistem arsimor gjithpërfshirës parauniversitar, duke u rekomanduar institucioneve që të marrin masat e duhura për këtë qëllim, duke përfshirë: Lehtësimin e të mësuarit të alfabetit Braille, lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave si dhe trajnimin e stafit që punon në të gjitha nivelet arsimore komunale, trajnime të cilat duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me nevoja të veçanta.

♦ Hartimi i Planit të Veprimit për personat me nevoja të veçanta, në periudhën 2021-2023, në bashkëpunim me OJQ-të që operojnë në komunën e Drenasit. Ky plan i veprimit vë në pah mbështetjen e personave me nevoja të veçanta dhe fokusohet në shpenzimet e fushave të rëndësishme, duke i klasifikuar prioritetet.

Ky raport është shqyrtuar dhe miratuar nga anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK

Anëtarët e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara:

1. Shemsi Bërbatovci (kryesues)

2. Ariana Isufi (zëvendës kryesues)

3. Arlindë Krasniqi (anëtare)


4. Burim Fazliu (anëtar)

5. Jehona Abdylit (anëtare)



Foto nga mbledhjet e mbajtura në vitin 2020- KKPAAK DRENAS





REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GJLLOGOC			
GJLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		14/01 2021	
Nj. Org.	NUMËR	Shtjësja	Vlera
12	052/01-1869		



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit
Municipality of Drenas

Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Drenasit për vitin 2020

Gjatë vitit 2020, ne, Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi mbajtur gjashtë mbledhje, raportet e të cilave janë dorëzuar më kohë tek personat përgjegjës. Për shkak të situatës së krijuar me pandemin COVID 19, takimin e parë e kemi mbajtur online. Në këtë takim kemi diskutuar sfidat e fushëveprimtarisë që mbulon komiteti ynë, kemi hartuar planin e veprimit për vitin 2020 si dhe kemi ndarë detyrat dhe përgjegjësitë për secilin anëtarë të komitetit.

Takimin e dytë e kemi mbajtur me datën 26 qershor 2020 në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit me aktivistë dhe artistë të fushave të ndryshme kulturore, të cilët veprojnë në komunën e Drenasit. Në këtë takim diskutuam këto pika të rendit të ditës:

1. Funksionimi i grupeve të ndryshme artistike në Drenas
2. Organizimi i festivaleve në komunën e Drenasit dhe rëndësia e tyre
3. Funksionimi dhe zhvillimi i arteve pamore në Drenas
4. Mundësitë për aktivizimin e Teatrit të Qytetit në Drenas
5. Zhvillimi i politikave kulturore në Drenas, etj.

Përveç tjerash në këtë takim kemi realizuar edhe një sondazh me të pranishmit për të kuptuar më mirë nevojat e artistëve të Drenasit. Rezultatet e dala nga ky sondazh janë shfrytëzuar për dhënien e rekomandimeve për fushën e kulturës në raportin përfundimtar të hartuar nga komiteti ynë për vitin 2020.

Pyetësoni që është shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave e gjeni në shtojcën A.

Takimin e tretë po ashtu e kemi mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal në Drenas me datën 29 shtator 2020 me sportist dhe udhëheqës të klubeve sportive që funksionojnë në Komunën e Drenasit. Në këtë takim kemi diskutuar këto pika të rendit të ditës:

1. Funksionimi i klubeve sportive në komunën e Drenasit
2. Organizimi i aktiviteteve sportive gjatë periudhë së pandemisë COVID 19
3. Idetë për zhvillimin e politikave sportive në Drenas (Mundësitë e aktivizimit të klubeve sportive në sported olimpikë që i mungojnë komunës sonë, si atletikë, gjimnastikë, xhudo, ski, etj.) etj.

Edhe në takimin me udhëheqësit e klubeve të ndryshme sportive në Drenas kemi realizuar një sondazh me të pranishmit për të kuptuar nevojat e sportistëve në komunën tonë. Gjithashtu rezultatet e këtij sondazhi janë shfrytëzuar për dhënien e rekomandimeve për fushën e sportit në raportin përfundimtar për vitin 2020 të hartuar nga komiteti ynë. Pyetësoni që është shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave nga sportistët dhe udhëheqësit e klubeve sportive në Drenas e gjeni në shtojcën B.

Takimin e katër e kemi mbajtur me aktivistë dhe udhëheqës të OJQ-ve, të cilët veprojnë në Komunën e Drenasit, e që fushëveprimtari e kanë rininë. Takimi është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit me datën 22 tetor 2020. Në këtë takim kemi diskutuar këto pika të rendit të ditës:

1. Nevojat e të rinjëve në Komunën e Drenasit
2. Ndikimi i pandemisë COVID 19 në organizimin e aktiviteteve rinore në Drenas
3. KVRL, plani i organizimeve si dhe nevojat që ka kjo organizatë
4. Bashkëpunimi i OJQ-ve me shkollat e mesme të larta në Komunën e Drenasit, etj.

Gjithashtu për të kuptuar më mirë nevojat e të rinjëve në Komunën e Drenasit kemi realizuar një sondazh me të pranishmit në këtë takim. Rezultatet e këtij sondazhi janë shfrytëzuar për dhënien e rekomandimeve për fushën e rinisë në raportin përfundimtar për vitin 2020 të hartuar nga komiteti ynë. Pyetësoni që është përdorur për mbledhjen e të dhënave gjendet në shtojcën C.

Takimin e pestë e kemi mbajtur me drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit zt. Muhamet Gjoka me datën 27 nëntor 2020 në ambientet e ndërtesës së Komunës së Drenasit. Në këtë takim kemi diskutuar këto pika të rendit të ditës:

1. Sfidat e organizimit të mësimit në kohë pandemie
2. Paisja e shkollave me teknologji dhe mjete tjera të konkretizimit
3. Nxënësit me nevoja të veçanta – sfidat dhe përkrahja
4. Rekrutimi i mësimdhënësve të rinj, konkurset, transferet, etj.

Përfundimet e nxjerra nga ky takim u shfrytëzuan për dhënien e rekomandimeve për fushën e arsimit në Komunën e Drenasit në raportin përfundimtar për vitin 2020 të hartuar nga komiteti ynë.

Takimin e gjashtë e kemi mbajtur me Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Drenasit zt. Labinot Halilaj. Ky takim është mbajtur me datën 28 dhjetor 2020 në ndërtesën e Komunës së Drenasit. Në këtë takim kemi diskutuar për punën njëvjeçare të Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Drenasit si dhe i kemi dorëzuar rekomandimet e hartuara nga komiteti ynë për vitin 2020 për fushëveprimtarinë që e mbulon komiteti ynë.

Rekomandimet

Bazuar në kompetencat tona ligjore, ne, si Komitet Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, pas analizimit në detaje të fushëveprimtarisë që mbulon komiteti ynë, kemi nxjerrë këto rekomandime për Komunën e Drenasit, respektivisht për Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) si dhe për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS). Rekomandimet janë të ndara për secilën fushë. Fillimisht kemi paraqitur rekomandimet për fushën e arsimit. Mandej kemi vazhduar me rekomandimet për fushën e kulturës, fushën e rinisë dhe në fund kemi listuar rekomandimet që ndërlidhën me fushën e sportit.

Të gjitha rekomandimet kanë dalë pas hulumtimeve që kemi bërë, ne, anëtarët e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe pas takimeve të drejtëpërdrejta me mësimdhënës, drejtor shkollash, prindër, nxënës, student, sportist, udhëheqës të klubeve të ndryshme sportive, udhëheqës të ansambleve, që funksionojnë në komunën tonë, përfaqësues të OJQ-ve, që fushëveprimtari kanë kulturën, rininë dhe sportin, etj.

Rekomandimet për fushën e arsimit

Aktualisht ndodhemi në situatë të pandemisë COVID19, kështu që gjatë këtij viti shkollor edhe Komuna e Drenasit është ballafaquar me sfida thuajse të njëjta sikurse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Sidoqoftë për ta përballuar më lehtë këtë periudhë ne rekomandojmë që:

- DKA të vazhdojë t'i furnizojë shkollat me dezinfektues dhe maska, si dhe shkollat t'i respektojnë vendimet dhe këshillat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, me qëllim që t'i mbrojnë nxënësit, mësimitdhënësit dhe gjithë personelin e shkollës nga virusi SarsCOV2.
- Komuna e Drenasit, respektivisht DKA-ja të gjejë mënyra për angazhimin e mësimitdhënësve rezervë, sepse në shumë raste, kur një mësimitdhënës është izoluar për shkak se është infektuar me COVID19, nxënësit kanë mbetur pa mësues ose ai është zëvendësuar nga kolegët e tij në shkollë, që në shumicën e rasteve nuk kanë qenë të profilit përkatës.
- Komuna e Drenasit, respektivisht DKA-ja përmes shkollave t'i identifikojë nxënësit që vijnë nga familjet me kushte të vështira ekonomike, me qëllim që të gjejë mënyra për t'i përkratur këta nxënës duke i siguruar ndonjë paisje teknologjike (telefon të mençur, llaptop, televizor, etj). Në mënyrë që nëse vije deri tek organizimi i mësimit në distancë edhe këta nxënës të kenë mundësi t'i ndjekin mësimit.
- DKA-ja të gjejë mënyra që t'i kompenzojë me një shumë simbolike mësimitdhënësit, të cilët kanë numër të madhë të nxënësve në klasë, e që për shkak të pandemisë mësimit e mbajnë me dy ndërrime. Ngase DKA i kompenzon mësimitdhënësit, që zëvendësojnë kolegët e tyre, kur ata mungojnë për shkak të infektimit me COVID19. Por, NUK i kompenzon mësimitdhënësit, të cilët kanë numër të madh të nxënësve në klasë dhe me qëllim të respektimit të masave anti-COVID janë të obliguar që t'i ndajnë nxënësit në dy grupe. Dhe, me njërin grup mësimit e mbajnë në ndërrimin e parë, kurse me tjetrin në ndërrimin e dytë. Pra, këta mësimitdhënës mbajnë punë të dyfishtë.
- DKA të vazhdojë t'i pajisë shkollat me teknologji dhe mjete tjera të konkretizimit, sepse ende ka shkolla që kanë mungesë të theksuar të mjeteve të konkretizimit. Për më tepër ende ka shkolla, ku mungojnë edhe hartat, të cilat janë më se të domosdoshme për mbajtjen e mësimit në lëndën e gjeografisë.

- DKA të vazhdojë me ndërtimin e sallave sportive në shkolla, sepse shumë shkolla kanë vështirësi në organizimin e mësimit të lëndës së edukatës fizike gjatë periudhës së dimrit.
- DKA ta trajtojë seriozisht çështjen e nxënësve me nevoja të veçanta. DKA përmes psikologut t'i përkrahë shkollat, që kanë nxënës me nevoja të veçanta. Në shumë raste mësime të ndërhënësit dhe drejtorët e shkollave janë ankuar se përkundër kërkesave të tyre në DKA, shkollat NUK janë vizituar nga psikologu. Madje edhe në rastet kur psikologu e ka vizituar shkollën, ai NUK e ka trajtuar nxënësin drejtpërdrejtë, por vetëm ka këshilluar mësime të ndërhënësit. Kështu që DKA-ja të shqyrtojë seriozisht trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta drejtpërdrejt nga psikologu i DKA-së ose të punësojë psikologë me bazë në shkollë, për shkak se disa nxënës kanë nevojë për trajtim ditë nga psikologu. Po ashtu DKA-ja përmes ekipës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta të bëjë vlerësim objektiv të nxënësit duke marrë në konsideratë edhe raportet e psikiatrit dhe psikologut klinik. Në raste të jashtëzakonshme MOS të insistojë në përfshirjen e këtyre nxënësve në shkolla të rregullta, sepse janë barrë e papërbalueshme për shkollën dhe mësime të ndërhënësit, përfshirë këtu edhe mësime të ndërhënësit mbështetës.
- DKA duhet të hartojë një plan të detajizuar për sistemimin e mësime të ndërhënësve ekzistues, sepse viteve të fundit kemi rënie të shpejtë të nxënësve në komunën tonë. Pra, DKA të këtë kujdes me shpalljen e konkurseve për mësime të ndërhënës të rinjë, së pari t'i plotësohet norma mësime të ndërhënësve ekzistues apo edhe të shfrytëzohet mundësia e transferimit të mësime të ndërhënësve nga një shkollë në tjetrën. Gjithnjë duke u bazuar në performancën e mësime të ndërhënësit. Gjatë muajve të fundit ka pasur raste kur DKA-ja ka refuzuar kërkesat e mësime të ndërhënësve për transfer, përkundër faktit se mësime të ndërhënësit i kanë plotësuar të gjitha kriteret dhe kanë pasur referencë pozitive nga drejtori i institucionit. Për më tepër DKA-ja nuk ka shpallur konkurs të brendshëm, por ka shpallur konkurs të jashtëm. Kështu që, DKA duhet të këtë kujdes me listën e pagave, sepse numri i mësime të ndërhënësve që janë jashtë listës së pagave është duke u rritur. Përveç arsyeve të cekura më lart, numrit të rritjes së mësime të ndërhënësve jashtë listës së pagave i ka kontribuar edhe punësimi i asistentëve dhe mësime të ndërhënësve mbështetës për nxënës me nevoja të veçanta, të cilët janë të domosdoshëm, megjithatë DKA duhet të këtë shumë kujdes të mos e mbingarkojë sistemin me asistentë dhe mësime të ndërhënës mbështetës. Arsye tjetër është punësimi i koordinatorëve të cilësisë dhe bibliotekistëve jashtë kriterëve. Në këto raste NUK është

respektuar kriteri i numrit të nxënësve në shkollë. Nëse një shkollë ka 250-500 nxënës, asaj shkollë i takojnë katër orë për koordinatortë cilësisë dhe nuk i takon bibliotekist me normë të plotë. Mirëpo ka shkolla me këtë numër të nxënësve, të cilat kanë bibliotekist me normë të plotë dhe ka shkolla me numër më të vogël se 250 nxënës, e që kanë koordinatortë cilësisë me katër ose më shumë orë. Për ta zvogëluar numrin e mësimdhënësve që janë jashtë listës së pagave, DKA-ja mund t'i angazhojë disa koordinatortë cilësisë si mësimdhënës të gjuhës frënge, mëqë këta koordinatortë cilësisë e kanë këtë kualifikim dhe ka mungesë të mësimdhënësve të gjuhës gjermane. Ndërsa si gjuhë e dytë e huaj mund të mësohet gjuha gjermane apo gjuha frënge. Mandej të mos shpallen konkurse për mësimdhënës të rinjë, por të sistemohen bibliotekistët dhe koordinatortë tjerë të cilësisë në mësimdhënie.

- DKA të shfrytëzojë përvojat e komunave përreth dhe ta zgjidhë çështjen e pagesave të shujtave dhe udhëtimit të mësimdhënësve, sepse realizimi i këtyre pagesave përmes përmbauesve privat do ta dëmtojë buxhetin e komunës së Drenasit.

Rekomandimet për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Bazuar në takimet dhe hulumtimet e komunitetit konsultativ në fushën e aktivitetit kulturorë dhe rinorë në komunën e Drenasit, takimet me grupet e interesit si dhe me përfaqësues institucional kemi arritur në konkludim se megjithëse ka një rritje të aktiviteteve kulturore, rinore e sportive për nga numri e gjithashtu kualiteti që ato ofrojnë, ka akoma shumë për të bërë me qëllim që edhe komuna e Drenasit të zërë vendin që e meriton në fushën e pafund të artit, kulturës e aktiviteteve rinore. Marrë parasysh situatën pandemike, vlerësojmë lartë gatishmërinë e DKRS-së e cila disa herë është takuar edhe me pjestarë të komunitetit artistik, aktivistë, sportistë e përfaqësues të organizatave e gjithashtu edhe me komitetin konsultativ, për të gjetur një zgjidhje që të paktën të mos stopohen aktivitetet, por të mbahen ato që janë të mundshme dhe të realizohen duke u bazuar në mundësitë dhe hapsirën që situata pandemike ka krijuar. Nuk mund të themi që viti 2020 është më i miri sa i përket realizimeve mirëpo edhe ne si komitet jemi munduar që të jemi koherent e gjithashtu praktik duke realizuar takime e duke hulumtuar të gjithë potencialin e mundshëm me qëllim që edhe rekomandimet tona të jenë sa më reale dhe sa më të vlefshme me qëllimin e mirë që qytetit të Drenasit t'i shtohen aktivitetet kulturore, rinore e sportive. Të rinjët tanë të kenë sa më shumë hapsira punuese në të cilat mund të shprehin talentin

e tyre e mund të socializohen për një jetë dhe të ardhme më të mirë. Vlerësojmë se rekomandimet tona profesionale janë në shërbim të të mirës së përgjithshme e gjithashtu në të mirë të politikave komunale për zhvillim më të gjërë në fushat e lartpërmendura.

Më poshtë gjeni të rënditura disa nga rekomandimet të cilat mendojmë që janë më të nevojshme dhe më emergjente në komunën e Drenasit për vitin 2021.

KULTURË

- Të themelohet Teatri i Qytetit të Drenasit i cili duhet të jetë në varësi të Komunës së Drenasit, respektivisht DKRS-së si dhe Minsitrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo gjë tashmë është e rregulluar me ligjet e Kosovës (teatrot e themeluara në vitin 2020 në komunat tjera bazuar në ligjin tashmë në fuqi janë: Teatri i Gjilanit, Gjakovës, Mitrovicës, Podujevës dhe Suharekës). Është e pavend të flasim për rëndësinë e themelimit të teatrit, mirëpo, ai është i domosdoshëm për shkak të rëndësisë që ka në edukimin, socializimin, emancipimin e ofrimin e mundësive për të parë e përceptuar vepra artistike të cilat hera- herës për hirë të vërtetës janë prezente në Drenas. Mirëpo ato duhet të jenë aktive dhe profesionale. Gjithashtu kjo do t'i japë mundësi edhe komunitetit artistik, i cili është në numër të konsiderueshëm në komunën tonë e të cilën do të mund të zotëronin me shumë përgjegjësi dhe profesionalizëm veprat artistike me të cilat komuna do të prezantohej dinjitetshëm edhe në skenat tjera në nivel vendi e edhe më gjërë. Megjithëse, teatri është votuar në asamblenë e komunës së Drenasit, dhe kjo është e vlerësueshme, mendojmë që duhet të ndërmerren hapa më konkret drejt finalizimit dhe njëherë e mirë Drenasi të ketë një teatër në të cilin talentët e komunës sonë do të kultivonin aftësitë e tyre artistike. Ne si komitet jemi takuar edhe me drejtoreshën e DKRS-së e gjithashtu edhe me artistë të Drenasit, vullneti nga të dy palët nuk mungon, mirëpo, çështja e teatrit mendojmë që nuk i përket vetëm DKRS-së por çdo dikasteri të qeverisë lokale, kuvendit komunal e kryetarit të Drenasit me qëllim që gjërat të lëvizin më shpejt dhe kjo të bëhet e mundur.
- Fondet të cilat janë ndarë për kulturën në veçanti, mendojmë që janë minimale e krahasuar me dikasterin si ai i sportit, kanë një diferencë dhe raport jashtëzakonisht të dalluar mes njëri-tjetrit. Ne mendojmë që fondet për këto tre motor të shoqërisë e rinisë së Drenasit duhet të kenë më shumë përkrahje financiare e sidomos kultura. Financimi i

denjë është i domosdoshëm që aktivitetet dhe kualiteti të rritet në komunën tonë. Ne kemi parasyshë se mundësitë e komunës tonë janë të vogla mirëpo kërkojmë vullnetin e të gjithë përfaqësuesve institucional që t'i kushtojnë më shumë rëndësi në pikpamjen e investimit dhe ndarjes së mjeteve financiare sidomos për aktivitetet kulturore në Drenas, me qëllim që edhe përgjegjësia e realizuesve ndaj institucionit të rritet, mirëpo edhe të rinjët tanë të kenë numër dhe mundësi më të madhe në përfshirjen e tyre në aktivitete të ndryshme. Megjithëse, pak fonde kanë qenë të ndara për fushën e kulturës, shpërndarja e tyre ka qenë korrekte bazuar në rëndësinë e kërkesave që janë drejtuar dhe mundësive që ka pasur DKRS-ja në mbështetjen e tyre, mirëpo kërkohet më shumë investim që edhe DKRS të ketë mundësi më të mëdha financimi dhe mbështetje konkrete për artistët e organizatorët e eventeve të cilat mbajnë gjallë frymën artistike në Drenas. Nga takimet me grupet e interesit e sidomos me komunitetin artistik na është thënë që nuk mungon përkrahja morale nga përfaqësuesit institucional, respektivisht nga drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, mirëpo shpeshë-herë për shkak të mungesës së fondeve nuk është arritë që gjërat të konkretizohen nga të dyja palët, pavarësisht që nuk ka munguar vullneti dhe dëshira e dyanshme.

- Rekomandojmë komunën e Drenasit që të shqyrtojë mundësitë për të ndërtuar një sallë multifunkionale për aktivitetet kulturore në të cilën përfshihen teatri, salla koncertale, muzeu, biblioteka e qytetit, kinemaja, salla për prova teatrale e valleve dhe e baletit, sallë provash për orkestër, galeri punë për artistët vizuel të Drenasit, punëtori për skulptorë, piktorët etj. Amfiteatrin ose sallën e hapur për organizimin e eventeve të ndryshme të cilat parashikohen për stinën e verës. Marrja e vendimit për rrëzimin e sallës aktuale të kulturës në Drenas, megjithëse e dhimbshme për historinë që lë ajo pas vetes e në të cilën kanë punuar e vepruar shumë artistë e organizatorë me vite të tëra. Kjo sallë ka shërbyer edhe për realizimin e koncerteve, festivaleve e shumë aktiviteteve të ndryshme, kuptohet si diçka pozitive nëse ai objekt përfshirë edhe objektin e vjetër komunal janë të demoluar dhe nuk ka mundësi për riparim, mirëpo rekomandojmë që para se të rrëzohet, të përgatitet një plan se si do të duket salla e re, ose teatri i ri dhe ku do të vendosen këto, në cilën pjesë të qytetit nëse jo aty ku janë aktualisht. Nëse nuk rrëzohen atëherë rekomandojmë që të riparohen dhe t'u krijohet prapë mundësi artistëve që të zhvillojnë aktivitetin e tyre. Rekomandojmë që komuna të sistemojë artistët aktiv të cilët tashmë

përdorin atë objekt në funksion të zhvillimit të tyre profesional si dhe për realizimin e aktiviteteve të tyre.

- Të themelohet ansambli i qytetit i cili mund të jetë në varësi të DKRS-së dhe Ministrisë së Kulturës e cila gjithashtu është e rregulluar me ligjet e Kosovës, e në këtë ansambël mund të përfshihen antarë të të gjitha shoqërive kulturore artistike të cilat tashmë egzistojnë dhe veprojnë në Drenas siç janë: “Shotë Galica”, “Shqipet e Drenicës”, “Komorani”, “Ymer Alushani” etj. Me qëllim që komuna të ketë një ansambël gjysëmprofesional, dhe të prezantohet sa më dinjitetshëm në festivale brenda dhe jashtë vendit (p.sh. Ansambli “Obiliqi” në Obiliq). Duke ndërtuar një strukturë gjithëpërfshirëse dhe duke përqëndruar kualitetin në një ansambël të vetëm. Duke qenë në vartësi të DKRS-së dhe komunës së Drenasit edhe kjo e fundit përqëndron financimin në aktivitetet e këtij ansambli, i cili i përgjigjet direkt komunës e gjithashtu kjo rritë interesimin e të rinjëve dhe të rejave për të punuar më shumë dhe për të arritur që në të ardhmen të bëhen pjesë e saj. Pra, Komuna e Drenasit do të përfizonte një ansambël gjysëmprofesional me të cilin do të prezantonte vlerat e qytetarëve dhe komunës së Drenasit gjithandej, do t’u mundësohej të rinjëve dhe të talentuarve që të synojnë një ansambël qyteti që do të ishte e mirëseardhur për të gjithë. Edhe nëse grupet nuk shkrihen në një ansambël, sepse natyrisht edhe grupet amatore, të cilat mbledhin dhe mbajnë rininë brenda aktiviteteve të tyre duhet të gëzojnë mbështetje dhe padiskutim mundësi më të shumta të prezantimit të tyre, financim më të madh etj. Ky ansambël do të mund të themelohet nga fillimi, me konkurse të rregullta të pranimit të cilat janë të rregulluara me ligj mirëpo edhe të mblidhet një këshillë profesional artistik i cili do të mund të organizonte një gjë të tillë.
- Të krijohet një hapsirë, muze për ansamblin ndër më të vjetrit jo vetëm në Drenas por edhe në nivel të Kosovës, Sh.K.A “Shotë Galica” e cila në gjithë këto vite ka numër të madhë të çmimeve, mirënjohjeve, materialeve të cilat janë nga festivalet kombëtare e ndërkombëtare. Ky ansambël ka qenë dhe vazhdon të jetë një ndër ambasadorët e kulturës dhe traditës në Drenas dhe jo vetëm. Ansambël me traditë shumëvjeçare nga i cili kanë dalë figura të mëdha kulturore në vend. Një ndër prezantueset më të dinjitetshme të vendit tonë, meriton më shumë vëmendje dhe pse jo çmimet dhe të gjitha trofetë të shfaqen për publikun e gjërë dhe kështu edhe të shërbejnë si element krenarie por edhe si mjet nxitës për gjeneratat e reja.

- Të identifikohen ansamblet aktive në komunën e Drenasit dhe në varësi të punës që ato ofrojnë, numrit të anëtarëve që kanë, të rregullohet edhe ndarja e subvencioneve. Megjithëse një gjë e tillë sa ne jemi në dijeni ka ndodhur edhe në herat e kaluara kur janë ndarë subvencionet, mirëpo rekomandojmë që kjo të bëhet kriter për përfitim financiar nga Komuna e Drenasit. Gjithashtu kjo e fundit t'u krijojë hapsirë provash çdo ansambli, i cili provon se ka grup ekzistent dhe kualitet në atë që ata ofrojnë.
- Saipas artistëve të pavarur dhe profesional të komunës së Drenasit me të cilët kemi pasur takim konsultativ, kemi marrë një shqetësim se Galeria e Arteve (ish byfeja e komunës e cila gjendet në objektin e vjetër të komunës) nuk përmbushë asnjë kriter për zhvillimin e aktivitetit. Gjithashtu shqetësim tjetër, akoma më i madh është, gjithmonë sipas tyre (në raportet e mbledhjeve i keni me emra dhe mbiemra) ka një distancim të madh të atij grupi të “vogël” që punojnë aty me artistë tjerë, qytetarë dhe artistë të këtij vendi... dhe duket sikur e kanë privatizuar...! (duhet të verifikohet)
- Të rikthehen festivale të rëndësishme dhe historike siç janë “Ditët e Humorit”, “Revista Burimore Folklorike”, sepse kanë një rëndësi në rritjen e interesit për artin e bukur folklorik që e kemi si popull e gjithashtu për të sjellë ansamble të ndryshme nga anë e mbanë trojet shqiptare, ashtu siç kanë ardhë për çdo vit që nga viti 1962 e këtej.
- Të financohen më fuqishëm festivalet aktuale, shumë të rëndësishme siç janë “Drenasi Fest”, festival që dallohet për karakterin e veçantë që ka dhe “Muaji i Mërgatës”, meqë dallohet si festivali më i madh në nivel vendi, e i cili sjellë të mira qoftë kulturore, turistike e biznesore për atë kohë sa zhvillohet në Drenas. Ky festival mbledhë dhe përfshinë më shumë se 70 aktivitete për çdo vit, duke angazhuar një numër të madh të rinjëve në organizim dhe duke gjallëruar e ofruar mikëpritjen e merituar për mërgimtarët tanë.
- Të ndahen në fundvit çmime për artistët aktiv, të cilët dallohen për veprat e tyre dhe jo vetëm sportistët siç ka ndodhur këto vitet e fundit.
- Të shqyrtohet mundësia e paisjes me një skenë të re profesionale për artistët në rast aktivitetesh sepse skena aktuale tashmë është konsumuar dhe nuk ofron asgjë bashkëkohore. Po ashtu është e papërshtatshme për të zhvilluar aktivitetet për shkak të demolimit dhe “hargjimit” të saj në këto shumë vite që ka shërbyer për aktivitetet e Drenasit.

- Të riaktivizohet festivali i shkollave fillore, i cili ka treguar rezultate tepër të mira në të kaluarën.

Vlerësojmë DKRS-në për bashkëpunim e transparencë të mirë me komunitetin artistik në bazë të të dhënave që ne posedojmë, mirëpo edhe DKRS e edhe komuniteti artistik më shumë se kurrë mendojmë që kanë nevojë për përkrahjen e të gjithëve me qëllim të rritjes së potencialit artistik përfaqësues të secilit që kemi ne komunën tonë.

RINI

Komuna e Drenasit dallohet për një rini të shëndoshë, inteligjente e më shumë potencial. Këtë vit kemi parë se si KVRL e cila suportohet çdo vit nga DKRS-ja, ka realizuar disa projekte mjaft të rëndësishme në Drenas, sidomos në përfshirjen e shumë të rinjëve brenda rrjetit të saj, e të cilët gjithashtu kanë qenë të agazhuar edhe në festivalin “Muaji i Mërgatës”, ku kanë kryer punë të rëndësishme me shumë përkushtim dhe përgjegjësi. Kjo organizatë tashmë ka arritur të krijojë një strukturë të qëndrueshme të cilët për ditë tregojnë dhe shfaqin suksese të shumta në çdo aktivitet që ata angazhohen. Gjithashtu edhe Qendra Rinore në Drenas e cila ka një aktivitet të rëndësishëm në pikpamjen e përfshirjes së aktivitetit në shkolla etj. Sipas tyre ka një bashkëpunim shumë të hapur ndërmjet tyre dhe DKRS-së, mirëpo kanë disa kërkesa të cilat janë esenciale dhe të cilat duhet të merrën parasyshtë në politikat e aktiviteteve rinore.

- Në ndarjen e Bursave për nxënësit e dalluar që ndahen për çdo vit nga Kryetari i komunës dhe nga DKA-ja, të caktohet kriter pjesëmarrja në aktivitete rinore. Gjithashtu mendojmë se në këtë formë rritet interesimi i të rinjëve që të bëhen pjesë e aktiviteteve rinore, e gjithashtu stimulon të rinjtë nëpër shkolla që t’u bashkangjiten projekteve të ndryshme, pse jo në të ardhmen të bëhen ata nismëtar të iniciativave që kanë të bëjnë me rininë.
- Një ndër shqetësimet që është ngritur nga pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e mbledhjes së komitetit konsultativ me komunitetin rinor, ka qenë mungesa e bashkëpunimit të ndërsjellë me shkollat e mesme në Drenas. Ne mendojmë që duhet t’u rekomandohet drejtuesve të shkollave në Drenas që të bashkëpunojnë ngusht me aktivistët dhe aktivitetet rinore sepse është në të mirën e të gjithëve, dhe jo për shkak të mos bashkëpunimit të humbet një projekt shumë më dobi për shkollën siç kishte ndodhur vitin e kaluar ndërmjet OJQ “Qendra Rinore” dhe shkollave të mesme në Drenas. OJQ-të dhe

aktivitetet rinore janë në të mirë të shkollave e gjithashtu mund t'i ndihmojnë ato në realizimin e nevojshëm të seminareve, punëtorive të ndryshme në vetëdijësimin e të rinjëve për tema të ndryshme sociale, andaj duhet të mirrret parasyshtë të gjenden forma bashkëpunimi në kontinuitet ndërmjet shkollave dhe të rinjëve tanë.

- DKA dhe DKRS së bashku me Kryetarin e komunës të krijojnë një fond të veçantë për inovacion dhe teknologji në të cilën të rinjtë tanë të kenë mundësi të thellohen në atë që është bashkëkohore, teknologjinë, që sot për sot është gati e domosdoshme në pikëpamjen e avansimit dhe koherencës tek të rinjtë.
- Të organizohen të pakten 5 punëtori në vit nga DKRS në bashkëpunim me organizata me eksperiencë për trajnimin e organizatave të ndryshme me qëllim që të rritet kapaciteti i kërkesës dhe ofertës së organizatave në vend, me qëllim që të arrihet në inovacion dhe përpilimi i projekteve të aktiviteteve rinore. Të zhvillohen këto trajnime me qëllim ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve të cilat veprojnë në Drenas që të kërkojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për punët që bëjnë.
- Të ndërtohet një objekt i ri i Qendrës për të Rinjtë dhe aktivitetet Rinore (siç është ai i Prishtinës) me qëllim që të rinjtë të kenë adresë të saktë për të vazhduar me thellimin e tyre në aktivitete të ndryshme.
- Të organizohen kuize në nivel komunal, kuize inovative në të cilat përfshihet edhe teknologjia dhe këtë ta organizojnë të rinjtë për të rinjtë.
- Të bëhet një tryezë ndërmjet organizatave kulturore dhe atyre rinore në Drenas me qëllim të bashkëpunimit më të thellë ndërmjet tyre, sepse kapacitetet rinore shpeshë-herë mbesin tek antarët e organizatave (mungesa e fondeve të mjaftushme nganjëherë). Mirëpo mendojmë që duhet të ketë bashkëpunim më të thellë. Një ndër shembujt se si mund të funksionon mirë bashkëpunimi ndërmjet organizatës për kulturë dhe asaj për rini është festivali “Muaji i Mërgatës” organizuar nga OJQ Panajot Kanaci, e cila bashkëpunon ngusht me KVRL, Kryqin e Kuq, Shoqatën e Piktoreve etj.

SPORT

Mund të themi lirisht që sporti në Drenas e sidomos futbolli ka arritur shumë suksese dhe na ka bërë krenar në vazhdimësi, por a është e mjaftushme kjo?!... mendojmë që ka hapësirë për t'u

përqendruar akoma më shumë edhe në sporte tjera dhe kështu të shfrytëzojmë gjithë talentin që e kemi tek sportistët tanë, e këta të fundit të prezantohen sa më shumë e sa më mirë.

- Të sigurohet sallë për ushtrime për klubet e boksit në Drenas, ndër ta klubi i boksit “Drenasi”. Deri tani kjo e fundit i ka zhvilluar aktivitetet e tyre në shkollën “Rasim Këçina”, mirëpo ajo i është ndaluar nga drejtoria e shkollës. Gjithashtu klubi i Karatesë “Drenasi” ka të njëjtën kërkesë dhe mendojmë se ne mund të jemi mjaft konkurent e prezantues të denjë në sportet individuale siç është ajo e karatesë dhe e boksit, për këtë shkak atyre duhet t’u mundësohet hapsirë ushtrimesh e gjithashtu të kenë mbështetje më të madhe. Klubi i Shahut gjithashtu nuk ka vend për t’u trajnuar e kjo duhet të trajtohet seriozisht dhe njëherë e mirë të vendosen në një vend ku të gjithë mund të kryejnë me përgjegjësi trajnimet dhe kështu të na përfqësojnë në një të ardhme të afërt.
- Së fundi është hapur klubi i çiklizmit, gjë shumë pozitive për komunën tonë. Andaj kërkojmë që të mendohet seriozisht që të vendosen stazat e çiklistëve në komunën tonë, kështu mbrojmë edhe mjedisin dhe u japim mundësi qytetarëve që të lëvizin më lirshëm nëpër qytet e gjithashtu krijojmë një frymë europiane në komunën tonë duke anashkaluar sa më shumë të jetë e mudnur makinat. Ky klub, i cili ndodhet në Komoran dhe që është i vetmi i këtij lloji në komunën tonë ka nevojë për mbështetje të veçantë nga DKRS dhe komuna sepse si i tillë është i vetmi në komunën tonë.
- Ndërtimi i sa më shumë fushave sportive sintetike në komunën tonë është shumë i mirëpritur.
- Kur nxënësit e shkollave marrin pjesë në gara komunale në sporte si futboll, volejball etj., të sigurohet transporti i këtyre fëmijëve qoftë nga DKRS, apo nga DKA dhe kjo gjë mos t’u ngarkohet vetëm pedagogëve ose aq me keq nxënësve, sepse fundja ata përfaqësojnë vendin tonë.
- Turniri i mirënjohur i futbollit në Nekovc dhe turnire të tilla që organizohen nga grupe, individë e organizata sportive në vendin tonë duhet të kenë përkrahje më të madhe financiare, çdo aktivitet sportiv në Drenas na shërben ne që të rrisim kapacitetet, si të tilla nganjëherë është më mirë të mos financohen klubet e mëdha, sepse fundja ato financim kanë, por t’u kushtohet vëmendje këtyre klubeve e organizimeve të vogla me qëllim që edhe këto të bëhen të mëdha një ditë.

- Klubi i shahut për femra i hapur së fundi në Drenas është shenjë emancipimi shoqëror dhe duhet përkrahur patjetër dhe të ngritet zëri i tyre sa më shumë të jetë e mundur. Duhet t'u sigurohet sallë për trajnim e gjithashtu fondet e nevojshme që ky klub i veçantë të funksionojë.
- Poligoni për çitje, një ndër sportet më interesante, intriguese e shumë të vlerësuara në vendet e zhvilluara mungon në Drenas. Ndërsa Agron Mala ka gjetur donatorë për ta ndërtuar një poligon të tillë, i cila do ta kthente vëmendjen e sportistëve të këtij lloji në komunën tonë. Mjafton që komuna të ndaj një lokacion. Mendojmë që kjo gjë duhet të trajtohet seriozisht nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse dhe të mos humbasim këto mundësi.
- Meqë tashmë ligji për sponzorizim ka hyrë në fuqi është një lehtësim i madh për çdo sportist ose klub në komunën tonë e gjithashtu është me interes për bizneset bashkëpunuese të cilët duan të financojnë sporte të ndryshme e të cilët nuk janë shumë të informuar se si funksionon ky ligj i veçantë. Andaj ne rekomandojmë që DKRS-ja së bashku me klubet sportive dhe përfaqësuesit e saj të organizojnë një takim konsultativ me bizneset e Drenasit dhe aty të diskutohen mundësitë e mbështetjes e cila besojmë që nuk do të mungonte dhe kështu edhe komuna do të hiqte një barrë të financimit nga vetja.

Në fund, shpresojmë se rekomandimet tona do të trajtohen seriozisht dhe do të merren si të mirëqena dhe dobiprurëse për arsimin, kulturën, rininë dhe sportin në Drenas.

Komitetit Konsultative për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Drenasit

Gentrit Mulaku – kryetar

Resmije Krasniqi - nënkryetare

Nuhi Nika - anëtar

Zyrafete Morina - anëtare

Robert Nuha - anëtar

Shtojca A

ANKETË E KOMITETIT KONSULTATIV PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT NË KOMUNËN E DRENASIT

Kjo anketë realizohet me personat që merren me aktivitete kulturore në Komunën e Drenasit. Qëllimi i anketës është të kuptojë, se sa janë të kënaqur këta persona me organizimin e aktiviteteve kulturore në komunën tonë. Këto të dhëna do të përdoren për dhënien e rekomandimeve DKRS-së, me qëllim që të gjenden format e përkrahjes së tyre nga Komuna e Drenasit, gjë që do të ndikonte në zhvillimin e kulturës në komunën tonë.

1. Cili është profesioni juaj?
 - a. Aktor/e
 - b. Regjisor/e
 - c. Këngëtar/e
 - d. Anëtar i ndonjë ShKA
 - e. Piktur/e
 - f. Skulptor/e
 - g. Tjetër (specifiko) _____
2. Sa ofron mundësi Komuna e Drenasit që ju ta zhvilloni aktivitetin tuaj?
 - a. Shumë
 - b. Pak
 - c. Aspak
 - d. Nuk e di
3. Sa jeni të kënaqur me organizimin e aktiviteteve kulturore në komunën e Drenasit?
 - a. Shumë
 - b. Pak
 - c. Aspak
 - d. Nuk e di
4. Sa jeni të kënaqur me ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Drenasit për organizimin e aktiviteteve kulturore?
 - a. Shumë
 - b. Pak
 - c. Aspak
 - d. Nuk e di
5. Çfarë aktiviteti mendoni ju se duhet të organizohet në Komunën e Drenasit?
 - a. _____
 - b. _____
 - c.
6. Ju lutem shënoni, nëse keni ndonjë sygjërim, vërejtje apo kritikë për zhvillimin e kulturës në Komunën e Drenasit.

Shtojca B

ANKETË E KOMITETIT KONSULTATIV PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT NË KOMUNËN E DRENASIT

Kjo anketë realizohet me personat që merren me aktivitete sportive në Komunën e Drenasit. Qëllimi i anketës është të kuptojë, se sa janë të kënaqur këta persona me organizimin e aktiviteteve sportive në komunën tonë. Këto të dhëna do të përdoren për dhënien e rekomandimeve DKRS-së, me qëllim që të gjenden format e përkrahjes së tyre nga Komuna e Drenasit, gjë që do të ndikonte në zhvillimin e sportit në komunën tonë.

1. Çfarë përfaqësoni?
 - h. Klub sportiv
 - i. Sportist
 - j. Mësimdhënës i edukatës fizike
 - k. Tjetër (specifiko) _____
2. Sa ofron mundësi Komuna e Drenasit që ju ta zhvilloni aktivitetin tuaj?
 - e. Shumë
 - f. Pak
 - g. Aspak
 - h. Nuk e di
3. Sa jeni të kënaqur me organizimin e aktiviteteve sportive në komunën e Drenasit?
 - e. Shumë
 - f. Pak
 - g. Aspak
 - h. Nuk e di
4. Sa jeni të kënaqur me ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Drenasit për organizimin e aktiviteteve sportive?
 - e. Shumë
 - f. Pak
 - g. Aspak
 - h. Nuk e di
5. Çfarë aktiviteti mendoni ju se duhet të organizohet në Komunën e Drenasit?
 - d. _____
 - e. _____
 - f.
6. Ju lutem shënoni, nëse keni ndonjë sygjërim, vërejtje apo kritikë për zhvillimin e sportit në Komunën e Drenasit.

Shtojca C

ANKETË E KOMITETIT KONSULTATIV PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT NË KOMUNËN E DRENASIT

Kjo anketë realizohet me personat që merren me aktivitete rinore në Komunën e Drenasit. Qëllimi i anketës është të kuptojë, se sa janë të kënaqur këta persona me organizimin e aktiviteteve rinore në komunën tonë. Këto të dhëna do të përdoren për dhënien e rekomandimeve DKRS-së, me qëllim që të gjenden format e përkrahjes së tyre nga Komuna e Drenasit.

1. Çfarë përfaqësoni?
 - l. Person fizik (vetëm vetën)
 - m. Një grup të rinjesh
 - n. OJQ që fushëveprimtari ka rininë
 - o. Tjetër (specifiko) _____
 2. Sa ofron mundësi Komuna e Drenasit që ju ta zhvilloni aktivitetin tuaj?
 - i. Shumë
 - j. Pak
 - k. Aspak
 - l. Nuk e di
 3. Sa jeni të kënaqur me organizimin e aktiviteteve rinore në komunën e Drenasit?
 - i. Shumë
 - j. Pak
 - k. Aspak
 - l. Nuk e di
 4. Sa jeni të kënaqur me ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Drenasit për organizimin e aktiviteteve rinore?
 - i. Shumë
 - j. Pak
 - k. Aspak
 - l. Nuk e di
 5. Çfarë aktiviteti mendoni ju se duhet të organizohet në Komunën e Drenasit?
 - g. _____
 - h. _____
 - i.
 6. Ju lutem shënoni, nëse keni ndonjë sygjërim, vërejtje apo kritikë për përkrahjen e rinisë në Komunën e Drenasit.
-



Kryesuesi i KAKRS

Gendrit Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GJLOGOC			
GJLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	14.01	20.21	
Nj. Org.	Numër	Shitja	Vlera
12-052-	1927		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Komiteti Konsultativ për mbrojtje të Ambientit Zhvillim
Ekonomik, shëndetesi dhe Mirëqenie sociale



RAPORT VJETOR

Raport Vjetorë per vitin 2020

Fiore Sefiu Shabani

DRENAS 2020

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Komiteti Konsultativ për mbrojtje të Ambientit Zhvillim
Ekonomik, shëndetesi dhe Mirëqenie sociale



Nr. 12-052/01-1927 dt. 19.01.2021

Raport vjetorë për vitin 2020

Dokumenti në fjalëpërban një përmbledhe të mbledhjeve të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Mjedisit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (më tuje KKZHEMMSHMS) të cilat janë të dokumentuara me fotografi dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, si dhe temat e diskutimit.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Përmbajtja

Përmbledhje.....3

Takimet Formale

Takimi I parë.....5

Takimi I dytë7

Takimi I Tretë.....9

Takimi I Katërt.....13

Takimi I Pestë.....15

Takimi I Gjashtë.....17

Takimet Joformale

Takimet Joformale.....19

Rezultatet dhe Përfundimi.....24

PËRMBLEDHJE

Aktualisht është viti i dytë që Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Mjedisit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale vepron në kuadër të Komunës së Drenasit.

Për të gjithë ishte një vit i vështirë, edhe ne si komitet kemi pasur vështirësi në arritjet e qëllimeve tona.

Kemi pasur gjashtë takime formale dhe tre takime joformale. Takimet janë thirrur nga kryesuesi e po ashtu edhe nga anëtarët e komitetit. Pjesëmarrës të takimit ishin të gjithë anëtarët e komitetit siç vijon:

1. Fitore Sefiu-Shabani-kryesuese
2. Burim Dvorani-nënkryesues
3. Arbresha Haziri-anëtare
4. Violeta Ipshi-Bujupi-anëtare
5. Basri Gashani-anëtarë

Në takime kemi pasur të ftuar drejtorë të dikastereve të ndryshme, kemi dhënë rekomandime si gjatë diskutimeve, e po ashtu edhe me shkrim, e të cilat gjithmonë janë marrë parasysh.

Për punën tonë është njoftuar edhe opinion publik për mes faqes që kemi hapur në njërën nga rrjetet sociale nga e cila kemi shqyrtuar edhe disa probleme që qytetarët na kanë njoftuar përmes saj.

Pavarësisht se ishte një vit zyrtë shkaku i pandemisë, fundviti u përmbyll me mbështetjen e aktivitetit për shpërndarjen e mbi 1000 dhuratave për fëmijë.

Duke besuar se pas çdo vështirësie do vijë edhe lehtësimi duhet edhe më shume të inkurajojmë projekte që për qëllim kanë përmirësimin e mirëqenies sociale për banorët tanë.



Fitore Sefiu Shabani

Kryesuese e komitetit

TAKIMET FORMALE

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Takimi I parë

Mbledhja e parë për vitin 2020 e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 18.02.2020. Të ftuar në këtë mbledhje patëm Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Arsim Haxhiu. Temat e diskutimit në këtë takim ndër të tjerat ishin:

- 1.Shëndetësia Në Komunën e Drenasit,
- 2.Vaksinimi I fëmijeve,
3. Furnizimi me Vaksina për grip Sezonal,
4. Mundësia e sjelljes së aparaturës për hemodializë për pacientët e Komunës tone.

Gjatë një takimi me personelin shëndetësorë që vaksinojnë fëmijët, hasë në një problem ku kishte fëmijë të cilët qe nga lindja nuk ishin vaksinuar.

Nga ky problem qe hasëm, e pamë të arsyeshmë që të kemi një takim me Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Arsim Haxhiu.

Me këtë rast e njoftuam z.Haxhiun dhe njëherit **rekomanduam edhe me shkrim që të bëjnë një kërkim të mëtejshëm në bashkëpunim me zyrën për Mirëqenie Sociale ngase ka shumë mundësi që personat me asistencë sociale nga pamundësia neglizhojnë procesin e vaksinimit të fëmijeve.**



Fig 1. Takimi me Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Arsim Haxhiu.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Furnizimi I Komunës tonë me Vaksinën kundër gripit sezonal për vitin 2019 ishte dikun 3000 vaksina. Edhe këtu mungon vedisimi I qytetarëve të cilët kanë të drejtë të vaksinohen e sidomos ata persona qe vuajnë nga sëmundjet kronike.

Në këtë rast poashtu rekomanduam që të bëhet një fushatë nga e cila qytetarët e komunës tone të dijnë se ekziston diqka qe mund te shpëtoje nga prekja e gripit e qe për dikend qe vuan nga ndonjë sëmundje mund të jetë fatale.

. Në komunën tone janë rrethj 35 pacienta të cilët iu duhet që Shërbimin e dializës ta marrin rreth 40km larg Komunës.

Nga drejtoria është kërkuar që psi qe ka një numër kaq të madh të pacientave, të bëjë të mundhsmëe që këtë shërbim të mund ta kryejmë në Qendrën e Mjeksise ketu në Drenas. Të bëhëtr trajnimi I personelit mjeksorë dhe të sjellin aparaturën e nevojshme për këtë shërbim.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

TAKIMI I DYTË

Takimi i dytë i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 28.04.2020. Të ftuar në këtë mbledhje ishin kryetari I Komunes z.Ramiz Lladrovci,si dhe drejtorët z.Arsim Haxhiu, znj Egzona Jetullahu dhe z.Milaim Hajdari.

Temë e diskutimit ka qenë :

- 1.Menaxhimi I situatës së krijuar nga COVID-19.
- 2.Humbjet ekonomike te bizneseve, dhe
- 3.Të ndryshme.

Nga Kryetari Lladrovci u njoftuam për së afërmi me veprimet të cilat I ka ndërmarrë Komuna e Drensit për të menaxhuar sa më mirë gjendjen emergjente shëndetësore.

Kryetari po ashtu na njoftoi edhe për pakot ushqimore-higjienike që ka ndarë komuna së bashku me donatorët për familjet në nevojë.



Fig.2.Takimi me kryetarin e Komunës dhe Drejtorët.

Nga Drejtoria e Shëndetësisë jemi të informuar se janë marë të gjitha masat po që se ka fluks të të infektuarve nga Corona virus.Po ashtu, vlenë të theksohet se në komunën tonë dy qendra të mjeksisë familjare punojnë 24h.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Nga Drejtorati për Ekonomi u njoftuam për masat që ka marrë kjo drejtori. Të gjitha bizneset që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në hapsirat e komunës gjatë kohës sa nuk kanë punuar janë të liruar nga pagesa e qerasë përderisa nuk i'u bëhet ndonjë kompensim nga niveli qëndror.

Nga Drejtoria e Inspektionit na është kumtuar se të gjitha objektet që kanë për qëllim qytetarët që nuk kanë bërë dezinfektimin e hapsirave që kanë frekuentim nga qytetarët nuk u lejohet ushtrimin e veprimtarisë së tyre deri sa të mos kryhet dezinfektimi.

Komiteti jone ad hoc rekomandoi që të ju bëhet ndonjë lehtësim bizneseve duke marrë parasyshë humbjet gjatë kohës sa ato nuk kanë mundur që për shkaqe sigurie dhe vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë të zhvillojnë veprimtaritë e tyre.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Takimi I tretë

Mbledhja e tretë për vitin 2020 e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 05.06.2020.

Temat e diskutimit ka qenë :

1. Shënimi I Ditës ndërkombetare të MJEDISIT 05.06.2020
- 2.Asfaltimi I rrugës Sadri Muqolli në Poklek të vjetër
- 3.Rregullimi I pjesës së mbetur të Lumit që kalon nëpër vendbanimin Drenasi –III-
4. Në Poklek të ri hudhen mbeturina nga qytetarë të pandërgjegjshëm

Me organizim nga Komuna e Drenasit përkatësisht, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente ishim pjesë e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit.Aktivitetet që shënuan këtë ditë ishin: Mbjellja e Drunjëvenë Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta :”Rasim Kiqina”, “Halil Bajraktari” dhe “Arif Shala”.



Fig.3.Shënimi I ditës ndërkombëtare të mjedisit

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Hetem Beka përfaqësuesi I lagjës Poklek I Vjetër na kumtoi se rruga Sadri Muqolli është përgatitur për asfaltim mirpo ka mbetur e pa asfaltuar dhe, është ndërpre larg shtëpisë së fundit 130 metra. Shtëpia është e banueshme por rruga që qon deri aty në rast të të reshurave bëhet e pa kalueshme.

Përfaqesuesi I lagjës kërkohet të dihet kur do të vazhdojnë punimet për asfaltimin e rrugës dhe a ka mundësi që rruga në fjalë të shtrohet të paktën me zhavor.



Fig,4.Pjesë e rrugës që qon te shtëpia e fundit



Fig.5.Nderpreja e punimeve në rrugën deri në përfundimin e saj

Rregullimi I pjesës së mbetur të Lumit që kalon nëpër vendbanimin Drenasi –III-

Në vijim siq shihet edhe nga fotot është një papsterti e pa përshkrushme.



Fig.6.Ura mbi Lumin në Drenas –III-

Kemi kërkuar të dijme se kur do të vazhdohet me projektet që kanë mbetur në gjysmë siq është edhe rregullimi I shtratit të lumit dhe definimi kanalete të ujrave të zeza?

Po ashtu në Poklek të ri hudhen mbeturina nga qytetarë të pandërgjegjshëm.

Qytetarët e asaj pjese problemin e tyre e adresuan ne Komitetin tonë me shpresë se do të mundemi të ju japim përgjigje. Ata kërkojnë që të ndriqojnë rrugën tyre ngasi sipas tyre për

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

shkak të errësirës që mbrëtëron në atë pjesë qytetarët e pandërgjeqshëm po e kanë të lehtë hudhjen e mbeturinave në atë pjesë.

Për të gjitha këto probleme që u ceken më lart kemi kërkuar përgjigje nga Drejtoria për shërbime Publike dhe Emergjente me një formë rekomandimi, document I cili nuk e dimë për qfar arsye nuk ka ran ë duae të drejtorisë.

Pasi kontaktuam me drejtorinë murëm përgjigje që problemet në fjalë do të shqyrtoheshin edhe njëhere duke dërguar personel për ti verifikuar.

Takimi I katërt

Edhe pse në kohë pandemie bledhjes e katërt për vitin 2020 e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 24.08.2020.

Tema të diskutimit ka qenë :

1. Diskutimi rreth dokumentit të hartuar për Vlersimin Strategjik Mjedisor,
2. Menaxhimi I situatës së pandemisë dhe rreziku që do të kanoset me fillim e vitit shkollorë



Fig.7. Anëtarët e komitetit

Nga shkencëtarët është konstatuar që fëmijët kanë potencial më të madh të përhapjes së këtij virusi se sa të rriturit, andaj duhej të merren masat që most të vije deri tek një numër I madh të infektuarve.

Dihet se kushtet për mbarë vajtjen për proceset mësimore vijnë nga niveli qëndrorë , por edhe nivelet komunale mund të ndikojnë dhe të hartojnë strategji qe do të ndikonin në mos rritjen e numrit të të infektuarve

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Temë tjetër diskutimi ka qenë edhe mungesa e shenjës STOP në fshatin Korroticë e Epërme më konkretisht te familjet Doshlaku, Shabani dhe Shapeta e cila është demoluar nga një aksident trafiku.



Fig.8.Mungesa e sinjalizimit

Me këtë rast **Rekomanduar Drejtorinë për shërbime Emergjente në rivendosjen e shenjës.**

Si përgjigje më tej se ky aks rrugor I perket Mirmbajtjes së rrugëve Regjionale.

Takimi I pestë

Takimi i pestë për vitin 2020 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 26.10.2020. E ftuar në këtë mbledhje ishte Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjete znj.Lumnije Krapa

Temat e diskutimit kanë qenë :

- 1.Qent endacak.
- 2.Planifikimi I komunes se Drenasit per menaxhimin e këtij problem,
- 3.Vizite në Kopshatin e femijëve ‘Ardhmëria’ në Drenas

Nga qent endacak po rrezikohen të gjithë e sidomos fëmijët. Siq e dimë së me ftohjen e kohës rreziku sa vjen edhe shtohet.

Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjete nga viti 2017 është marrë me këtë problem mirpo, ne vitin 2018 kompetencat për përkujdsin ndaj qenve endacak I ka marrë AVUK (Agjensioni I Veterines dhe Ushqimit I Kosoves). Nga kjo që u tha Komuna nuk ka mundësi të marrë vendime lidhur me këtë të problem. Por, në Maj të vitit 2021 kompetencat për mbikqyrjen tjtartinin e qenëve endacak do tu kalohen Komunave.



Fig.9. Takimi me znj.Krapa Drejtoreshë për Shërbime Publike dhe Emergjete

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Po ashtu ishim në një vizitë në Kopshtin e fëmijëve ‘Ardhmëria’ në Drenas ku u mirëpritëm nga drejtoresha e këtij institucioni znjsh.Fitore Berisha.

Nga drejtoresha u njoftuam më për së afërmime punën e këtij institucioni të arriturat dhe vështirësitë që ka ky institucion. Komiteti jonë shprehu gatishmëri që të ofrojë ndihmë në të gjitha projektet të cilat drejtoresha do t’I realizojë në ate institucion si në Drenas poashtu edhe në njësinë e ndarë në Bushat.



Fig.10. Vizita në kopshtin ‘Ardhmëria’ në Drenas.

Takimi I gjashtë

Mbledhja e gjashtë për vitin 2020 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 27.11.2020. Ishim në takim tek drejtori I Qendrës së Punësimit në Drenas Z. Ragip Dervishi.

Temat e diskutimit ishin :

- 1.Zbatimi I pakos emergjente
- 2.Statistikat për të papunët e regjistruar në këtë qendër,
- 3.Bashkëpunimi I qendrës së punësimit me Komunen dhe bizneset

Në zbatimin e pakos emergjente kishin hasur në shumë vështirësi.Shumë pak qytetarë kishin përfituar nga kjo pako.

Nga 4203 të pa punë sa ishin gjithsej të regjistruar në qendër, 2857 ishin punëkërkuës aktiv ndërsa 1346 ishin pasiv.

Nga ky numër 1214 ishin punëkërkuës të pashkolluar,preh të cilëve 708 ishin femra ndërsa 506 ishin meshkuj.

Pasuar nga 1079 që ishin me arsim të mesëm professional, 119 me shkollë të mesme gjimnaz, 207 me Bachelor, 21 Master dhe një (1) me Phd.

Qendra e Punësimit ofron edhe trajnime në punë, Subvencione në punë dhe praktikë në punë. Subvencionimi në punë është në bashkëpunim me UNDP duke participuar me nga 50%, trajnimi në punë zgjatë 6 muaj me pagesë prej 170 eurove ndërsa praktika në pune zgjate 6 muaj, 4 muaj paguan qendra e punësimit dhe 2 muaj punëdhënësi.



Fig.11.Takimime drejtorin e Qendrës së Punësimit z.Ragip Dervishi

TAKIMET JOFORMALE

Takimet joformale

Përpos takime formal të cilat janë gjashtë sosh kemi pasur edhe takime joformale nga të cilat veqojme edhe takimin që e kemi pasur me 11 Mars 2019 në Qendrën për punë Sociale me z.Elmi Dobra. Për së afërmi jemi njoftuar me mënyrën e funksionimit të Qendrës, familjet përfituese të stemës sociale, trajtimi I dhunës në familje, divorcet si rrjedhim I dhunës në familje e shumë problem të tjera që shumë qytetarë mund të gjejnë mbështetje.



Fig.12.Takimi me z.Elmi Dobra

Poashtu gjatë një vizite që kishim në QEAP “Ardhmëria” në paralelen e ndarë në Bushat për së afërmi u njoftuam për të arriturat po ashtu edhe për vështirësitë e kësaj qendre. Me ndihën e njerzve të vullnetit të mirë dhe me përkrahjen tone kemi arritur që për fëmijet të sigurojmë perdë të errësuar pa të cilat gjumi I fëmijeve është tjejet I vështirë.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020



a.

b.



c.

Fig.13.a.Perdja e errët tek grupmoshat 4-5vjet, b.garnishten tek grupmoshat 4-5vjet dhe,c.perdja e errët tek grupmoshat 3-4 vjet.

Me organizim të Drejtorisë Për zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me bizneset si “Giza Architecture” dhe “Lucky’s Cakes” dhe biznese tjera poashtu me punën vullnetare të Komitetit tonë bëmë shpërndarjen e dhuratave për fëmijë , shoqatën Handikos dhe të tjerë.Gjatë shpërndarjes së dhuratave fëmijët patën rastin të argëtohen duke shpresuar se sadopak janë larguar nga gjendja e monotonisë së krijuar nga gjendja e pandemisë.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

Aktiviteti u zhvillua më 28.12.2020 në sheshin e qytetit “Fehmi Lladrofc” duke respektuar rekomandimet për mbrojtjen nga Covid-19.



Fig.14. Aktiviteti në shpërndarjen e dhuratave tek sheshi dhe qendra Handikos

Rezultatet dhe përfundimi

Si për të gjithë edhe për Komitetin tonë ka qënë një vit sfidues e me vështirësitë e tij nga shkaktari I cili tashmë e një vit ka kapluar gjith globin, duke na kufizua rrynyrën e jetesës, punës e të gjitha aktiviteteve në përghithesi.

Edhe pse me vështirësi takimet tona si ato formale dhe joformale kanë qenë të frytshme dhe konstruktive duke bërë rekomandime të qastit si dhe me skrim.

Vlenë të theksohet se rekomandimeve tona u janë përgjigjur pa hezitim drejtorite si Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjenca.

Ngjarjet që e kanë karakterizuar këtë vit kanë qenë aktivitetet vullnetare që Komiteti jone ka realizuar, të cilat vetëm se u përmendën më lart në këtë document.

Ndonëse ishte një vit me vështiresitë e veta shkaku I pandemisë, ne këtë vit e pëmbyllëm me buzëqeshjet e ëmbla të fëmijëve gjate shpërndarjes së dhuratave në shesin “Fehmi Lladrofici”ku zëri I fëmijëve mbushi plotë jetë gjith qytetin.



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit
Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore



12 Nr. 052/01-1872, dt. 14/01/2021

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR BARAZI GJINORE PËR VITIN 2020



ANËTARËT E KOMITETIT KONSULTATIV PËR BARAZI GJINORE
Janar - Dhjetor, 2020

Hyrje:

- Anëtarët e përzgjedhur të Komitetit Konsultativ për Barazi gjinore në Komunën e Drenasit gjatë periudhës **Janar- Dhjetor 2020**, kanë organizuar dhe mbajtur mbledhjet sa i perket këtij komiteti. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, **KKBGJ** ka mbajtur **7 takime**. Ku prej tyre mbledhja e pare ka qene mbledhje **jo formale** e cila ka shërbyer për njoftimin e anëtareve të komitetit mes tyre. Mbledhjet/ takimet tjera, **6** gjithsej kanë qene mbledhje te rregullta në të cilat përpos diskutimeve në fund te secilit takim ka rezultuar një rekomandim drejtuar institucioneve përaktese dhe komunes ne Drenas(Gllogoc).

Në secilin takim janë shqyrtuar pika te veqanta dhe rendi i ditës ka qene specifik për secilin takim të mbajtur. Secili takim ka pasur 3 e më shumë pika të përfshira si rend dite, ne total rreth (30) tridhjetë pika të shqyrtuara.

Secili takim është shoqëruar me proces verbal dhe raportimin adekuat, pra janë dorëzuar 6 procesverbale të mbledhjeve me lista të pjesëmarrësve.

Paraqitja e detajuar e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës në mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Barazi Gjinore gjatë periudhës janar-dhjetor 2020

Janar, 2020

Mbledhja e parë jo Formale e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur me **datën 24.01.2020**, ku janë shqyrtuar **(3)** tre pika të diskutimit dhe me këtë rend të ditës. Pas mbledhjes është përgatit raporti për Kuvend.

1. Hapja e takimit u bë nga kryesuesja e Komitetit znj. Halide Morina
2. Takimi i parë, njoftimi i anëtarëve te Komitetit.
3. Planifikimi vjetor i takimeve përgjat periudhes Janar- Dhjetor 2020.
4. Të ndryshme
5. Mbyllja e takimit.

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 31.01.2020, ku janë shqyrtuar (3)pika të rendit të ditës dhe është përpiluar një rekomandim:

1. Hapja e takimit u bë nga kryesuesja e Komitetit znj. Halide Morina
2. Sektori privat i punësimit
3. Orari i tejzgjatur i të punësuarëve në sektorin privat.
4. Të ndryshme.
5. Mbyllja e takimit.

Rekomandimi bazuar tek **Ligji i Punës(NR.03/L-212)**, i cili ka të bëjë me dërgimin e Inspektoratit te punës për verifikimin të kontratave dhe për ndalimin e punës në kundërshtim me ligjin e Punës në Republikën e Kosovës sipas se cilit parashikohen keto rregulla dhe vlerësime:

Elementet e marrëdhënies së punës dispozita përkatëse në Ligjin e Republikës së Kosovës Kontrata e shkruar, orët e punës në javë 40 orë .Orari i shkurtuar i punës Zbatohet për punët për të cilat punëtori nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme për shëndetin e tij, edhe përkundër aplikimit të masave mbrojtëse

Puna jashtë orarit: Me kërkesën e punëdhënësit në rastet e domosdoshme; më së shumti deri në 8 orë në javë, pushimi ditor 30 minuta (të përfshira në orarin normal të ditës së punës)

Pushimi javor Së paku 24 orë. Pushimi vjetor së paku 4 javë në vitin kalendarik (pavarësisht nëse punon me orar të plotë apo të shkurtuar); për çdo 5 vite punë shtohet një ditë pushimi.

Në rast sëmundjeje: 20 ditë pune në vit me kompensim të plotë të pages.

Në rast të pasigurisë dhe mosmbrojtjes së shëndetit në punë: deri në 45 ditë në vit me kompensim të plotë të pages.

Në rast të pushimit mjekësor prej lëndimit ose sëmundjes të shkaktuar nga kryerja e punëve dhe shërbimeve për punëdhënësin: 10 – 90 ditë në vit me kompensim deri në 70% të pagës 5 ditë në rast të martesës së punëmarrësit, 5 ditë në rast të vdekjes së një anëtar të ngushtë të familjes , 1 ditë për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci.Agjensisë së punësimit. Bizneseve Private.

Mars, 2020

Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 06.03.2020, ku janë shqyrtuar (3) pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerrur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatit raporti dhe rekomandimi e KKBGJ.

1. Hapja e takimit u bë nga kryesuesja e Komitetit znj. Halide Morina
2. Ndarja e trashëgimisë në baza gjinore
3. Organizimin e fushatave vetëdijesuesë për të drejtën e femrës në trashëgiminë e Pronës Familjare.
4. Të ndryshme.
5. Mbyllja e takimit.

Rekomandimi i nxerur nga kjo mbledhje duke u **bazuar tek : Paragrafi 1 i nenit 3-të Ligjin për Trashëgiminë e Kosovës** i cili përcakton se, “Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi”, duke definuar qartësisht se ndarja e trashëgimit mes anëtarëve të familjes pa përjashtuar trashëgimtarë në baza gjinore”, andaj si perfundim nga ky takim rezultoi **rekomandimi per:** Organizimin e fushatave vetëdijesuesë për të drejtën e femrës në trashëgiminë e Pronës Familjare.

Fushata këto te cilat do te ndikonin ne ndërgjegjsimin e shoqerisë sonë dhe fuqizimin e pozitës së gruas.

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci. Shoqërisë civile.Organizatave të ndryshme funksionale në komunën e Drenasit.

Qershor, 2020

Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 01.06.2020, ku janë shqyrtuar (3) pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerrur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Hapja e takimit u bë nga kryesuesja e Komitetit znj. Halide Morina
2. Java e fëmijëve
3. Pjesëmarrja e barabartë e prindërve në kujdesin e fëmijes.
4. Të ndryshme.
5. Mbyllja e takimit.

Rekomandimi nga ky takim bazuar tek: **LIGJ Nr. 18/2017 PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS** i cili përcakton tek: **Neni 30 Ushtrimi i kujdesit prindëror** 1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj, pa cekur baza gjinore, andaj si perfundim nga ky takim rezultoi **rekomandimi per:**

Organizimin e një pako të veçantë me aktivitete për fëmijë në kuadër të “Javës për të drejtat e fëmijëve”, thirrje për pjesëmarrje dhe kujdes të barabartë nga prindërit dhe mundësia e adresimeve të shqetësimeve nga ana e prindërve në lidhje me fëmijët e tyre.

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci. Cerdheve dhe Zyrës për Barazi Gjinore.

Shtator, 2020

Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 28.09.2020, ku janë shqyrtuar (3) pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerrur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Hapja e takimit u bë nga kryesuesja e Komitetit znj. Halide Morina
2. Trajtimi që u bëhet moshave të shtyera
3. Hapësirat të cilat mungojnë për frekuentim nga këto moshë
4. Të ndryshme.
5. Mbyllja e takimit

Rekomandimi nga ky takim bazuar tek: **Ligji Nr. 04/L-075- PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT** i cili përcakton tek: **Neni 52 B Sporti rekreativ**, personat fizik dhe juridik mund të themelojnë klubet sportive recreative me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit, po ashtu se shoqatat mund të themelohen nga nga disa grupe sportive rekrative, pa cekur baza gjinore andaj si perfundim nga ky takim rezultoi rekomandimi per:

Krijimin e një hapësirë rekreacioni për tu shfrytëzuar veqanarisht nga moshat e vjetra.Në këtë hapësirë mund të përfshihen: një shetitore (ulëse& tavolina). Ne mendojmë që një hapësire e tille do të motivonte moshat e shtyera që të dalin dhe të kalojnë kohë jashtë.Zakonisht na bie te shohim gjyshërit tanë në sheshin e qytetit tonë, por mungon qartë të shohësh gjininë femërore kjo si pasojë e paragjykimeve se qka nësë e shef një grua në qendër të qytetit.

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci. Zyrës për Barazi Gjinore.

Tetor, 2020

Mbledhja e peste e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 14.10.2020, ku janë shqyrtuar (2) pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerrur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Hapja e takimit u bë nga kryesuesja e Komitetit znj. Halide Morina
2. Krijimi i aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese rreth kancerit te gjirit, zbulimit të hershëm dhe trajtimi i grave të prekura nga kjo sëmundje .
3. Të ndryshme.
4. Mbyllja e takimit

Rekomandimi nga ky takim bazuar tek: **LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI** i cili përcakton tek :

Neni 1 edhe Qëllimin e ligjit ku thuhet:

Ky ligj ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor.

andaj si perfundim nga ky takim rezultoi rekomandimi per: Organizimin e aktiviteteve per fushatë vetëdijesuese në përkrahje të grave që preken nga kanceri i gjirit dhe të bëhet thirrje për pjsëmarrje të meshkujve të cilët ndihmojnë këto gra të paktën moralisht.

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci.Organizatës Gratë për Gratë

Tetor, 2020

Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 29.10.2020, ku janë shqyrtuar (2) pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Hapja e takimit u bë nga kryesuesja e Komitetit znj. Halide Morina
2. Aplikacionet e punësimit/ konkurset të shqyrtohet terminologjia që përdoret në publikim e ketyre pozitave per punesim.
3. Të ndryshme.
4. Mbyllja e takimit

Rekomandimi nga ky takim bazuar tek: **LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS** i cili përcakton tek :
UDHËZIMI ADMNISTARTIV (MPMS) NR. 05/2014 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.14/2011 PËR RREGULLIMIN E PROCEDURAVE PËR
THEMELIMIN E MARËDHËNIES SË PUNËS NË SEKTORIN PUBLIK.

Andaj si perfundim nga ky takim rezultoi rekomandimi per: Aplikacionet e punësimit/ konkurset të shqyrtohet terminologjia që përdoret në këto aplikacione. Të mos përdoret terminologji e cila paraqet pabarazi gjinore. Zakonish nëpër konkurset e punësimit le të përmendim qerdhet shtetërore gjejmë shprehjen” Kërkohe një edukatore”, ky lloj shprehje përjashton të gjithë të kualifikuarit në këtë drejtim që i përkasin gjinisë mashkullore .

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci. Agjensise së Punësimit



Kryesuese e KKBGJ

Halide Morina
Halide Morina



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



01. Nr 353/01-3403 dt, 22/01 2021

Në bazë të nenit 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 par (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika 12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2021, të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për caktimin e lokacionit, për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu

I

Të MIRATOHET Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit “Asllan Fazliu”, zona kadastrale Drenas në parcelën nr. P-949-0, në pjesën ku rruga mban emrin e heroit.

II

Qëllimi i këtij vendimi është të bëhet caktimi i lokacionit në pronë komunale, në të cilën do të bëhet vendosja e shtatores.

III

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

V

Me këtë vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

VI

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.



A r s y e t i m

Duke pasur parasysh kontributin e dhënë të Dëshmorit të Kombit për çlirimin e vendit, Komuna e Drenasit cakton lokacionin për vendosjen e shtatores së heroit "Asllan Fazliu".


Familja Fazliu, ka ndërtuar shtatoren e heroit "Asllan Fazliu" me kontributin e familjes dhe bashkëluftëtareve të heroit, ndërsa Komuna e Drenasit merr për obligim caktimin e lokacionit për vendosje të shtatores.

Andaj, vendosja e shtatores ne parcelën nr. P-949-0, në zonën kadastrale në Drenas, vjen pasi që rruga në atë pjesë mban emrin e heroit, po ashtu ekziston hapësira e nevojshëm për ndërtim të sheshit dhe vendosje të shtatores.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka kryer të gjitha matjet e nevojshme gjeodezike dhe ka përgatitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për definimin dhe caktimin e lokacionit të shënuar më lartë.

Të bashkangjitur keni kopjen e planit, certifikatën e pronësisë si dhe skica e lokacionit.

CAKTIMI I LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E SHTATORES SË DËSHMORIT “ASLLAN FAZLIU”



Parcela ku do të vendoset shtatorja është me nr.P-00949-0 zona kad. Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gllogoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70315016-00949-0	Parcelë / Parcela / Parcel	13439



Shkalla/Razmera/Scale: 1:4911

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 22.01.2021

Koha/ Vreme/ Time: 10:52:09

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

[Handwritten signature]

Approv/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Shënshkrimi/Potpis/Signature:



[Handwritten signature]



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo - Government
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315016-00949-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 22012021
Data dhe koha e fëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 22.01.2021 - 10:50
Komuna / Opština / Municipality: GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Glogoc / Glogovac / Glogoc
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta inovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70315016-00949-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Inovina / Socially owned Land		13439			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
SEFERI/SEFERI/SEFERI				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shtyrtëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet class Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë Private/Private/Privat/Road		13439

B. PRONARI/POSEDEUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lidni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronitës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	PASURI SHOQËRORE- RRUGËT	KCID0300798	/ / /		GLLOGOVC	1/1		

